THOMAS BRANDON

TETUA E KARLLIT

Komedi në 3 akte

Përkthyer në shqip nga origjinali në anglisht
dhe e trajtuar me shumë ndryshime
për skenën shqiptare nga

Kristo Floqi

Botim i dytë.
Transkriptoi dhe përgatiti për botim
Henrik Kaçulini

Botimet Jozef, 2026

THOMAS BRANDON

TETUA E KARLLIT

Komedi në 3 akte

Përkthyer në shqip nga origjinali në anglisht
dhe e trajtuar me shumë ndryshime
për ssenën shqiptare nga
Kristo Floqi

Titulli në origjinal
"Charley's Aunt"

Botim i dytë
Transkriptoi dhe përgatiti për botim
Henrik Kaçulini
(Botimi i parë nga Shtypshkronja Dhori Koti, Korçë, 1939)

Në ballinë:
Aktori W.S. Penley në rolin e tetos së Karllit
karikaturë nga Alfred Bryan

ISBN 978-9928-941-86-2

Botimet Jozef, 2026
botimet. jozef@kad.al
www. kad. al

Dy fjalë për Kristo Floqin

(Sipas "Autobiografia ime" shkruar me shkrim dore nga Kristo Floqi)

-Lindi më 5 Nëntor 1872 në lagjen "Mantho" të qytetit të Korçës

-Më 1899, fiton titullin "Doktor i Drejtësisë" në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Athinës.

-Më 1900, shkon në Stamboll për të perfeksionuar gjuhën juridike turke, që i duhej për profesionin e tij të avokatit. Aty viziton idhullin e tij, Naim Frashërin, pak ditë përpara se ky të vdiste, gjithashtu takon edhe Sami Frashërin. Për këto takime arrestohet e burgoset për 19 ditë.

-Më 1905, martohet me Uranija Poçi, motrën e Marigo Posio (Themeliu), "Nënën e Flamurit Kombëtar Shqiptar".

-Më 1911 ai caktohet nga shoqëria "Besa-Besën" drejtor i gazetës "Dielli" në Boston (USA). Organizon 326 konferenca në kolonitë shqiptare, duke u bërë Ciceroni shqiptar në Amerikë për formimin e Federatës Pan-Shqiptare "Vatra", ku ai ishte inisiatori i themelimit të saj, në bashkëpunim me Faik Konicën dhe Fan Nolin. Në shumë nga këto konferenca ai shoqërohej nga prifti patriot At Naum Cërri.

-Më 1912, themelon në New-York gazetën “Zëri i Popullit"

-Më 1913, në një takim me gazetarët në Washington, ai me dy shqiptarë të tjerë, i paraqiti Presidentit Amerikan të sapo-zgjedhur, W.Willson, problemin e shqiptarëve, dhe mori prej tij

fjalën se, "nuk do ta lë kurrë Shqipërinë të vuajë" (Arkivi Qendror Shtetëror - A.Q.SH., Fondi 429 Dok .1 f.359.1-360).

-Merr pjesë në Kongresin Panshqiptar në Trieste (26 shkurt – 6 mars 1913).

-Në Prill 1913, emërohet Kryetar i Gjykatës Civile dhe të dënimeve, në Vlorë, duke u bërë kështu gjykatësi i parë i Shtetit të pavarur shqiptar, dhe jep Vendimin e parë gjyqsor në historinë e drejtësisë shqiptare në gjuhën shqipe. Harton një fjalor prej më se 5.000 termash dhe fjalish juridike që përdoren edhe sot në drejtësinë shqiptare (A.Q.SH, Fondi 429 Dok.1, fq. 385).

-Më 1913-1924, Av.Vasil Floqi, Thanas Floqi dhe Kristo Floqi janë marrë me shqipërimin e legjislacjonit turk, duke ia përshtatur legjislacionit perëndimor. Unë kam trashëguar prej tyre gati 100 volume librash juridikë të viteve 1910-1943, kryesisht në frëngjisht, italisht dhe greqisht, me të cilët ata kanë punuar.

-Më 08 prill 1920, boton në Shkodër "E drejta themelore ose konstitucjonare", që është trajtimi i parë shkencor për hartimin e një Kushtetute shqiptare që do t'i fuste shqiptarët në gjirin e popujve të qytetëruar e të civilizuar.

-Më 1921, ftohet nga princi Wied në rezidencën e tij në Aachen. Princi, në gjuhën shqipe e dialektin shkodran, e informon se po përgatit një forcë gjermane për vendosjen e rregullit në Shqipëri dhe i propozon postin e Ministrit të Pallatit, me marrjen e Fronit Mbretnor, propozim që pranohet nga K.Floqi. Wied i jep dekoratën e komandarit të Shkabës së zezë.

-Më 1922, harton tekstin e "Marshit të Zogut" në respekt të punës së Ahmet Zogut si Ministër i Brendshëm për suksesin e arritur, duke thyer ushtritë e ardhura nga Shijaku që donin të përsëritnin rrebelimin e vitit 1914 të Haxhi Qamilit. Ky tekst

muzikohet nga dardhari Thoma Nasi (dirigjent i bandës së Tiranës) dhe kur Zogu bëhet Mbret, "Marshi i Zogut" bëhet Hymni Kombëtar Shqiptar.

-Më 21 Janar 1925, Shqipëria shpallet për herë të parë Republikë. Po atë ditë, miratohet edhe Kushtetuta e parë e Shtetit Shqiptar, bazuar në trajtimin shkencor të parimeve për një Kushtetutë Perëndimore, bërë nga K.Floqi në "E drejta themelore ose Kushtetuese".

-Më 1926, Mbreti i Italisë, Viktor Emmanueli III, e dekoron K.Floqin si Commendator me medaljen e "Koronës së Italisë".

-Në Maj 1928, K. Floqi thirret nga Presidenti A.Zog, në cilësinë e këshilltarit juridik, për t'i marrë mendimin mbi ndryshimin e Regjimit Republikan me regjimin Monarkik. K.Floqi e këshillon që Shqipëria duhet të jetë Republikë dhe i përmend të këqijat që do kishte ai vetë dhe shqiptarët nga Monarkia, të cilat fatkeqësisht rezultuan të vërteta, pas disa kohësh. Në Parlament, K.Floqi ishte i vetmi ndër 57 deputetët e kohës që kundërshtoi kthimin e Shqipërisë nga Republikë në Monarki, duke propozuar zgjedhjen e një Asambleje Kushtetuese (pra është i pari që propozon organizimin e referendumit popullor për ndryshimin e Kushtetutës). Kur A.Zogu bëhet Mbret, ai heq dorë nga politika, i kthehet profesionit të avokatit dhe e quante Mbretin Zog rrenacak e megalloman.

-Më 1936, emërohet anëtar i Këshillit të Shtetit dhe mbas 1939, caktohet Kryetar i tij, detyrë që e mbajti deri më 1943.

-Më 1944, ftohet nga komunistët të marrë pjesë në Kongresin e Përmetit, por ai e refuzon.

-Më 29 Dhjetor 1950, vdes në spitalin e Tiranës, në varfëri të plotë.

-Rreth vitit 1970, një buldozer, duke punuar për ndërtimin e disa banesave, aty ku ishin varrezat e Tiranës, i hedh eshtrat e

njerëzve të varrosur, mes tyre edhe ato të Kristo Floqit, në themelet e shtëpive që po ndërtoheshin, në zonën që sot njihet si "Parafabrikatet". Trashëgimtarët e Kristo Floqit arritën të gjejnë e të shpëtojnë vetëm eshtrat e djalit të tij, Pirro Kristo Floqi.

Shumë herë është thënë se Kristo Floqi ka qenë në burg, nga fundi i vitit 1945 e deri më 1950, duke u shpallur fajtor, si autor i himnit të mbretërisë. Thuhet edhe se vdiq i vetmuar, i përbuzur e i braktisur, në vitin 1951. Ndokush është shprehur edhe se ka vdekur në burg. Këto nuk janë aspak të vërteta. Këto gënjeshtra janë thurur nga njerëz arrivistë, për të përbaltur figurën e Kristo Floqit.

Unë zotëroj tre dokumenta autentikë, që janë prova të plota, me anën e të cilave vërtetoj se K.Floqi nuk ka qenë asnjë ditë të vetme në burg, dhe se nuk ka qenë në survejim nga sigurimi i shtetit komunist. Nga burime të sigurta familjare vërtetohet se Kristo Floqi ka vdekur më 29 dhjetor 1950 në spitalin e Tiranës në Paqe me Zotin e me asistencën e personelit mjeksor Tiranë. Ai është përcjellë në banesën e fundit shoqëruar me bekimet e gruas së tij Urania, të djalit të tij Pirro, të mbesës Vjollca Floqi dhe bashkëshortit të saj, Theodhor Luarasi (i biri i botuesit patriot Kristo Luarasi). Besoj se Zoti i ka dëgjuar lutjet e katër fëmijeve të tij, të vdekur në moshë të njomë, dhe besoj se gjithë familja e tij është e bashkuar në Parajsë, para dritës së Zotit.

Në vitin 1943, Kristo Floqi i dëshpëruar konstaton se shqiptarët, të gënjyer nga të huajt dhe për llogari të tyre, po vriteshin njëri me tjetrin.

Në atë vit ai shkroi:

O e vërtetë q' humbe, që s'kè shpresë shpëtimi,
Dritën ta zu gënjeshtra, ti s'kè një vleftë sot,
Se vleftën e ka rrena, e keqja e mashtrimi,
Ku jè o moj e ngratë, që nuk po të gjenj dot?

Në këtë gjëndje shpirtërore, ashtu si Krishti Biblik, edhe Kristo Floqi, në moshën 71 vjeçare, ia dorëzon shpirtin e tij Perëndisë, duke shkruar:

Vargonjtë që më lidhin në jetën e përkohshme
Dua t'i thyenj gjithë, ç'do sent që më vjegon,
Dhe pranë Perëndisë me krahë të palodhshme
Dua të shkonj t'afrohem, zembra fort ma dishron!
Në jetën e pasosur, që s'ka as funt as krye,
Aty dua të gjendem, të çlodhem, të dëfrenj,
Të shoh madhnit' e Zotit krijesat që ka krye
Një jetë krejt të ndryshme brenda n'ato të gjenj!

dhe përfundon:

Mê mirë le të dalim nga kjo qeli e shkretë,
Prej ktij burgu të ngushtë, ku shpirti po rënkon,
Të flutrojmë lirë e të shetisim lehtë,
Në jetën e pasosur, ku gjë nuk na mungon,
Atje ku s'ka vent cmiri, ahmarrja e e keqja,
Ku mbretëron e drejta, ku nuk dëgjon ankim,
Ku nuk ka duk lakmija, ku nuk të tremp as vdekja
Atjè flutrò e ikë dhe ti, o shpirti im!

Është e vërtetë se K. Floqi vdiq në varfëri të plotë materjale, ashtu siç vdiqën shumë shqiptarë të tjerë gjatë regjimit komunist, por vdiq i pasur, shumë i pasur shpirtërisht. Këtë pasuri shpirtërore të tij, K. Floqi e ka shprehur më 1919, në një vjershë kushtuar At Gjergj Fishtës, në këto vargje:

Deh, sa dishirojsha
Qi n' at vallen t' uej, t' andëshm' e lyrike
T' mujsha m' u afritë, vallen me këcye,
Fyll nji gêm ullinit kish me më vleftë aqe
Sa gjith pasuniët, gjithë farë dhuratet.

Kurse për varfërinë materjale, ku edhe ai vetë përfundoi, në vitin 1925, ka shkruar:

"Do t'ishte shum' i gjatë katallogu i poetëve të famëshëm e i shkrimtarëve, të cilët u madhnuan e llamburitnë në për mes të mjerimevet. Po edhe shqenca ka edhe ajo martyrët e saj. Shum zbulime nga ato më të mbëdhat si edhe çpikje u bënë në mes të ndjekjeve e të poterave".

Henrik Kaçulini

Tiranë, Korrik 2024

Vepra letrare e Kristo Floqit

Dr. Henrik Kaçulini na sjell një listë të gjatë të veprës letrare dhe studimore të Kristo Floqit. Këtu mund të përmendim,

Dramat: "Fè e kombësi", "Karllo Topija", "Pirro Neoptolemi", "Triumfi i Lirisë", "Fat-zeza", "Skënderbeu n'Itali", "Qypërlinjtë", "Omer-ag-Ulqini", "Meço Qafëzezi",

Komeditë: "Rrogat e nëpunësve", "Lodrat e studentëve", "Do të vras vehten", "Vllazëri e interesë", "E bij' e banqerit", "Dhëndër me përdhuni", "Merre t'a marrim", "Nder e qytetni", "Kundrështarët e prikës", "Psimet – mësime", "Zi e më zi", "Reklamë e blofë", "E mbes' e krahinarit", "Akraballëket", "Ministri kandidat", "Doktorllëket", "Veteranët", "Fat i papritur", "Përfundimet e zilisë", "Burri burrë", "Usta Patozi", "Muratorium", "Horr-horr Topalltija", "Kopanët e batatis", "Zuzarkat", "Të tërbuarit".

Farsa e monologje: "Një nat' e tmeruar", "Gungaçi", "Si do të vejë halli", "Byrokratija", "Shpina jeme".

Operetat: "Një natë Krishtlindjesh", "Babagjyshi".

Shkrimet Juridike: "E Drejta Themelore", "Administrata", "Ekonomia politike e shoqnore", "Ligja e Përmbarimit".

Studimet historiko-letrare: "Historija e Greqisë", "Historija e Romës", "Historija e Shqipërisë", "Historija e letërsisë shqiptare", "Kritoni i Platonit", "Patriotizmë e Nacionalizmë", "Fjalor i gjuhës shqipe me 22.000 e sa fjalë".

Poezitë dhe satirat: "Tingëllimet e zembrës", "Tallaze e valë", "Shkëndija", "Shqyptarët", "Qerthulli politik", "Epopè e Korçës", "Epopè e Vlorës (Lahuta e Labërisë)", "Epopè e Skënderbeut".

Studime, poezi, vjersha e artikuj (mbledhur andej-këndej nga Henrik Kaçulini): "Fjalor i terminologjisë juridike" (me skanime teknike prej 5.000 e sa termash e shprehjesh juridike që përdoren edhe sot në sistemin juridik shqiptar), "Pellasgë e helenë" - studim etnologjik e linguistik, "Kosova (Serbi e vjetër?)" - studim ethnografik e statistik, "Hymn për mbretin Wied", "Marshi i Ahmet Zogut" (hymni i mbretërisë shqiptare), "Tempulli i Dodonës" - studim arkeologjik, "Formimi i shoqerise Vatra" - artikull, "Kont Ugolini" - poezi nga "Divina commedia", "Vdekja e Sokratit", "Mikut te vlertë Ndre Mjeda" - poezi kushtuar dom Ndre Mjedës, "Është i pavdekur shpirti?" - poezi, "Ankim i qiparizit" - poezi, "Shka don me thânë autonomi" - artikull, "Autobiografia ime", me 1788 faqe[1], "Ismail Qemali – Beqir Grebenea" – kujtime historike.

Gjithashtu, Kristo Floqi është shquar në lëmin e gazetarisë, duke themeluar dhe drejtuar disa gazeta, si:

Gazeta "Indipendenca shqiptare" (janar 1925 - korrik 1926)

Gazeta "Zëri i popullit", 1912 në New-York.

[1] "Autobiografia ime" e Kristo Floqit me shkrim dore me 1788 faqe në 4 volume, ndodhet në Arkivin Qëndror Shtetror Fondi 429 Dok. 1

Revista "Agimi" organ letrar i shoqërisë "Vllaznija", Shkodër.

Gazeta "Shqiprija e re", e përdyjavshme, Milano[1].

Kristo Floqi ka përkthyer edhe tragjeditë "Mbreti Oedipus", "Antigoni" dhe "Elektra" të Sofokliut, tragjedinë "Medêa" të Euripidit, komedinë "Kopraci" të Molierit, dramat "Fedora" dhe "Atdheu" të Victorien Sardou, komedinë "Tetua e Karllit" të Thomas Brandon, dramën "Të dy rashterët", studimin "Karakteri", poezinë "Poeti dyke vdekur", etj.

Komedia e Thomas Brandon, "Tetua e Karllit", përkthyer me mjeshtëri nga Kristo Floqi, na u paraqit për botim nga familja e Kristo Floqit, falë punës së lavdërueshme dhe tejet impenjative të zotit Henrik Kaçulini, i cili ka bërë sistemimin dhe transkriptimin, jo vetëm të kësaj komedie, por të të gjithë veprës së shkrimtarit, atdhetarit dhe politikanit, sa të njohur, po aq edhe të harruar, në ditët e sotme, Kristo Floqi. Teksti i komedisë është sjellë i pandryshuar, në dialektin korçar, ashtu siç e ka përdorur autori, në përkthimin e tij.

Shpresojmë se me lejen e familjes së tij dhe me bashkëpunimin e zotit Henrik Kaçulini, do ta sjellim të plotë për lexuesin shqiptar, veprën e plotë të tij.

Botimet Jozef

[1] Shënim: Kjo listë e veprave të Kristo Floqit është hartuar nga vetë ai dhe është botuar tek "Tingëllimat e zembrës", botim i vitit 1940.

THOMAS BRANDON

TETUA E KARLLIT

Komedi në 3 akte

E përkthyer Shqip nga Inglishtja
dhe e trajtuar me shumë ndryshime
për sqenën Shqiptare

prej

Kristo Floqit

Këndonjësve

Kur isha në Boston, Mass. të Amerikës, si Drejtori i Gazetës DJELLI dhe në atë kohë kur formonim FEDERATËN PANSHQIPTARE "VATRA", një natë u ndodha në një theatër të Bostonit, ku ngjerova[1] një nga komeditë mê të bukura të komedianit të famshëm engles THOMAS BRANDON, me titullin "Tetua e Karllit", komedi tepër hymoristike, që na ka fikur gazit të gjithëve, që e dëgjuam. Qysh atë natë ajo komedi mu përshtyp thellë në shpirt dhe nuk e pata harruar. Duke e sjellë sot ndër mënt, edhe me gjithë që nuk e pata tekstin anglisht përpara, dhe vetëm ashtu si e imazhinoja, vendosa t'ja paraqit publikut Shqiptar, i sigurt se, kur ta shohë të çfaqur do kënaqet me të tepër dhe do qeshë me gjithë zembër. Komedinë e trajtova si për sqenën Shqiptare, tuke shtuar, si pas zakonit t'em, disa sqena hymoristike, nga ato që i pëlqejnë popullit t' onë e që i shijon me aqe lezet.

Kristo Floqi
Tiranë 25 Mars 1939

[1] ngjerova = shijova, u kënaqa

PERSONAZHI I AKTORËVET

Frank Baverley	– Student, shok
Jak Tsesney	– Student, shok
Karll Whitegham	– Student, shok
Francesk Tsesney	– i ati i Jakut
Luçija Allvadorès	– tetua e Karllit.
Emma Brown	– bij'e adoptuar e Luçisë Allvadores
Spetting	– një pasanik, kujdestar i Ketyt e Annës
Ketty	– mbesë dhe e kujdesur e Spettingut
Anna	– mbesë dhe e kujdesur e Spettingut
Brasset	– Shërbëtori i Jak Tsesneyt

Sqena në Londër, nga viti 1890

ROYALTY THEATRE.

Sole Lessee ... ... Miss KATE SANTLEY.

Under the Management of Mr. W. S. PENLEY.

On WEDNESDAY, DECEMBER 21st, and Every Evening at 9 o'clock,

Will be produced the Farcical Comedy, entitled

CHARLEY'S AUNT

By BRANDON THOMAS.

Stephen Spettigue	... (Solicitor, Oxford) ...	... Mr. ERNEST HENDRIE
Col. Sir Francis Chesney, Bart.	... (late Indian Service) ...	Mr. BRANDON THOMAS
Jack Chesney Charley Wykeham Lord Fancourt Babberley	... Undergraduates, St. Olde's College, Oxford) ...	Mr. PERCY LYNDAL Mr. H. FARMER Mr. W. S. PENLEY
Brassett	... (College Scout)	Mr. CECIL THORNBURY
The New Footman	... ...	... Mr. G. GRAVES
Donna Lucia D'Alvadorez	... ... (from Brazil)	... Miss ADA BRANSON
Amy Spettigue	... (Spettigue's Niece) ...	... Miss KATE GORDON
Kitty Verdun	... ... (his Ward) ...	... Miss NINA BOUCICAULT (By permission of C. H. Hawtrey, Esq.)
Ela Delahay	... (an Orphan) ...	... Miss EMILY CUDMORE

Time.—the Present. Commemoration Week. Oxford.

Act I.—Jack Chesney's Rooms in College.

"When pious frauds . . . . . are dispensations."—*Hudibras.*

Act II.—Garden outside Jack's Rooms. "While there's tea, there's hope."—*Pinero.*

Act III.—Drawing Room at Spettigue's House. "Dinner lubricates business."—*Boswell.*

(The Piece produced under the direction of the Author.)

Preceded at 8.15 by a Comedietta, entitled

A LOVE GAME,

By WALTER BROWSE.

Jack May	(in love with Rosa Leigh)	... Mr. WILTON HERIOT (By permission of C. H. Hawtrey, Esq.)
Rosa Leigh	... (in love with Mr. Jack May)	... Miss EDITH LISLE

Scene ... ... Drawing Room at Mr. Leigh's.

Business Manager	... Mr. HENRY DANA
Assistant Manager	Mr. FRANCIS GOSNAY
Musical Director	Mr. FRANZ GRŒNINGS

Wigs by FOX. Furniture, &c., by OETZMAN & Co. Piano by KIRKMAN & Co.

Engravings and Etchings by Messrs. DOWDESWELL & DOWLESWELLL, 130, Old Bond Street.

MATINEE EVERY SATURDAY, AT 3 O'CLOCK.

PRICES OF ADMISSION:—Private Boxes, £2 2s., £3 3s., and £4 4s.; Stalls, 10s. 6d.; Dress Circle, 6s.; Upper Circle, 4s.; Pit, 2s.; Gallery, 1s.

Box Office open 11 to 5, and during the Performance. Doors open at 7.45. Carriages 11. Seats can be secured by Telegram and at all Libraries.

Opera Glasses, 1s. 6d., can be had of the Attendants. ICES, TEA AND COFFEE.
All ICES sold at this Theatre are supplied by The HORTON ICE CREAM Co., Queen's Road, Bayswater.

Posteri i shfaqjes, në Londër, në dhjetor të vitit 1892

TETUA E KARLLIT

AKT I

(Një sallon pensjoni. Në mes, një tryezë e gjatë, në funt një derë, djathtas një garderobë e madhe. Dy dyer djathtas e majtas. Afër një dritore një tryezë e vogël që përdoret si shkrestore. Disa frona rrotull).

SQENA 1

JAKU e KARLLI

JAKU

Jam mejtuar t'i shkruaj një letër Kettyt e ta ftonj këtu për darkë. Si thua edhe ti?

KARLLI

Shumë mirë do bësh.Tamam atë mejtonja edhe unë, t'i shkruanja Annës.

JAKU

Bukur fort. Atëhere duhet t'i ftojmë sa më parë, se më duket se që të dyja nisen këto dit' për Scotland, për ndrim ajri, po nuk di se ç'shkak duhet t'ju paraqitim, se kam frikë se nuk do t'a pranojnë ftimin t'onë dhe nuku do vijnë.

KARLLI

Kam një mendim, po s'di në do ta pëlqesh edhe ti.

JAKU

Çfarë mendim? Pa ta dëgjojmë.

KARLLI

Kam një teto....

JAKU

Çudi e madhe! E kush nuku ka teto? Di ç'ka na the edhe ti!

KARLLI

Prit pak, mos u ngut. Tetua ime ndryshon nga tetot e tjera, se ajo është pasanike është milionare munt të të them.

JAKU

Ç'thua? Vërtet? Pse s'më paske thënë kaqe kohë tani?

KARLLI

Po nuku je bërë pak merak si jetoj kaqe mirë, si më sheh? T'a merr mendja, ajo më dërgon të holla, që jetonj kështu? ajo më mban.

JAKU

Bravo ! He, pra, ç'deshe të më thuash me këtë teton tënde?

KARLLI

Tetua ime quhet Dona Luçija Alvadores, është martuar me një milionar në Brezil e tash sa vjet i vdiq burri e ka trashëguar gjith ato milionra. Unë s'e njoh personalisht, të të them të drejtën, veç se me anë letrash. Ajo ka blerë një villë të madhe jashtë Londrës dhe tani po vjen të qëndronjë këtu për gjithënjë. Si trashëgimtar të vetëm, që besonj të më ketë, do më bënjë bir për shpirt dhe do jetojmë së bashkut.

JAKU

Ashtu thuaj, deh; ti qënke për të puthur në ballë! (*e puth*). I lumi ti! Hè, pastaj?

KARLLI

Me qënë se teto-Luçija është më të ardhur e sipër, unë mejtohem, që çupave t'u vemë për shkak ardhjen e saja, e kështu t'i ftojmë të dashurat tona në gosti. Si thua ti?

JAKU

Shumë mirë je kujtuar. Të kam thënë se ty ta pret mendja për gjëra të këtilla, dhe jè, me të vërtet, për të shtrënguar dorën.

KARLLI

Hè, ç'thua tani, ta merr mendja se do mbarojmë punë?

JAKU

Sigurisht. S'kam as një dyshim. Po, kur kujton se munt të vijë jot' emtë? Ke ndo një lajmë?

KARLLI

Un' e mar me mënt se sonte do t'a kemi këtu, se më telegrafoj.

JAKU

Ahere shkruaju shpejt zojushavet (*I jep letër e bojë*)

KARLLI

(*Mbassi shkruan letrën ja këndon Jakut:)*

"*Të dashura zojusha ANNA dhe KETTY",*

"Me qënë se sonte vjen prej Brezilit tetua ime e dashur DONA LUÇIA ALVADORES, e cila do më adoptonjë, si birin e

saj, kemi nderin t' ju ftojmë të na nderoni sonte me ardhjen t' uaj. Do na detyroni shumë dhe do gëzohet edhe tetua ime kur t' ju shohë. Përgjigjmuni shpejt".

Me dashuri. KARLLI.

(Jakut) He, si të duket kjo letër?

JAKU

Bukuri! Dërgoje shpejt me shërbëtorin t'em Brasset. (*Bërtet*) Braset, Braset eja shpejt ....

SQENA 2

TË PARËT, BRASSET

BRASSET

(*Jakut*)

Urdhro, Zotni, jam nënë urdhrin t'uaj.

JAKU

(*Si e mbyll letrën në pliko ja jep Brassetit*).

Na këtë letër dhe shko shpejt u a dorëzo zojushave Anna e Ketty. Po, shëko mirë, mos të të shohë njeri. Merrju edhe përgjigjen. Marsh ....

BRASSET

E mora vesh, zotni, po shkonj fill.

JAKU

Ndalu pak. Po të kuptosh se zojushat munt të vijnë, shko nga pazari të blesh mish, peshk, zarzavate, fruta, gjalpë, djathë, verë etj. dhe na pregatit një darkë për nja pesë, a gjashtë veta. More vesh?

BRASSET

Bukur fort, zotni, por paret ....

JAKU

Merr veresije, pa i paguanj unë, më njohin ata mua.

BRASSET

Ashtu? (*Tunt kokën*). Ahere mirë, por në qoftë se s'më kreditojnë?

JAKU

Këput qafën shpejt, s'dua fjalë. Bëj ashtu si të thashë (*Brasset del*).

SQENA 3

JAKU, KARLLI, FRANKU

FRANKU

(*Tuke hyrë*)

Akoma këtu jini? S'paski shkuar në Universitet? (*rëmben një cigare prej Jakut*). Kam tre ditë që s'kam pirë duhan.

JAKU

Lere më nj'anë Universitetin Frank, sot s'kemi punë me mësime.

FRANKU

Si ashtu? Si e kini hallin?

KARLLI

Ne po presim sot teton t'ime nga Brezili e po pregatitemi ti bëjmë një darkë të mirë.

FRANKU

Nga e kini këtë teto, nuk më thua edhe mua ta di?

KARLLI

Është një kushërira e dytë, a e tretë, s'mbanj mënt, e s'im' ëme, unë s'e njoh personalisht, veç se kam dëgjuar se është e pasur mjaft, milionare, si më kanë thënë.

FRANKU

Milionare? Folë mirë! Ti qënke për sihariqe, po mos haro t'i bësh fjalë edhe për mua që kam mbetur ramôna[1].

JAKU

(*Frankut*)

Leri ato tani se s'kemi kohë. Ti do vish sonte për darkë?

FRANKU

Fjalë ësht'ajo për të thënë? A ndahet mishi nga thonjtë? Aqe ndahem edhe unë prej jush, e sidomos kur është fjala për dark'e drekë.

KARLLI

Mirë, mirë, e muarm vesh, po, pa na thuaj, në rast që kemi nevojë prej teje, a do na ndihmosh sa të mundësh?

FRANKU

Unë? Me mish e me shpirt, veç më thoni e më jepni të ha, se m'u zgurdulluan sytë nga urija. Të tjerat m'i lijni mua. Do kemi verë?

[1] ramona = i lirë, single, beqar

JAKU

Sigurisht, bëhet darkë pa verë, e bilè kur kemi edhe mysafirë?

FRANKU

Cilët mysafirë? Janë grâ, a po burra?

JAKU

Duro pak, pa e merr vesh.

KARLLI

(*I jep një puro të Havânës*).

Na një puro, se t'u ça hunda!

FRANKU

(*Tuke parë puron*)

Ho, ho, ho, ku i gjete, bre i mallkuar, a më mirë kujt ja grabite? S'të kam parë tjetër herë me puro.

KARLLI

Mos harro, se kam një teto milionare!

FRANKU

A, a, pardon. Tashti e kuptova.

JAKU

Vërë pak veshin e dëgjo këtu.

FRANKU

Urdhro e folë, po të dëgjonj.

JAKU

Nè, me shkak që po vjen tetua e Karllit, kemi ftuar për darkë edhe të dy zojushat t'ona, Kettyn dhe Annën. Ti i njeh mirë, po edhe në mos i njofsh s'prish punë. Pra, në qoftë se vonon të vijë tetua e Karllit, ti do qëndrosh këtu në sallon t'i mbash me fjalë ata që munt të na vizitojnë, se kështu nè do kemi kohë të fjalosemi veçanërisht me zojushat, ma se i bindim të fejohemi, dhe s' duam të na marrë vesh njeri. E kuptove?

FRANKU

Po, po, e kuptova (*Me vehte*). Morè, djajtë, se ç'mejtohen të bëjnë! Si lum prindët që i kanë dërguar këtu të mësojnë shqènxa! (*Jakut*) Edhe unë, pra, duhet të qëndronj këtu t'ju mbaj fenerin juve kopukëve!

JAKU

A, a, mos e merr për keq. Nè e dijmë se sa na do ti.

FRANKU

Ju dua, ju dua, po jo edhe të bëhem urë të më shkoni përsipër! Atë zanat s'e kam msuar akoma.

KARLLI

Mos u bëj budallë, nè të themi si mik, se edhe ti po të kishe nevojë ne nuk do të të theshnim jo kurrë! Pastaj mendoje mirë, se nuk do të të dalë keq, se po të martohemi ne me ato edhe ti do të kesh hair prej neve, si thua? Do na ndihmosh, apo jo, se fjalën na e dhe që në krye.

FRANKU

Ahere u kuptuam, më duket. Pra, jam nënë urdhrin e zotërinjve t'uaj.

JAKU

Tani fole mirë, bravo Frank! Mir' e kam thënë unë se ti je një thesar i fshehtë për në!

FRANKU

Ah, i pabukshëm, të jep dorë ajo fjalë, po neise, s'ka gjë.

KARLLI

Lijini fjalët dhe lè të fillojmë nga puna.

FRANKU

Po në arthtë tetua juaj?

JAKU

Tamam, ti do t'i mbash shoqëri, kur ne do të fjalosemi me çupat.

FRANKU

(*Karllit*)

Nuk më thua si quhet tetua jote?

KARLLI

Dona Luçija Alvadores edhe është e vehë.

FRANKU

Sa vjetsh është?

KARLLI

Po ç'të duhet ty të hysh në të thellat? Është 40-42 vjetsh.

FRANKU

Ekstra. E pranonj edhe 50 vjetsh akoma.

KARLLI

Për ç'arsyje?

FRANKU

Kaqe s'kupton? Që ta marr unë, në qoftë se ka ardhur për t'u martuar. Ku do të gjente më të mirë se mua? Si jam unë sot ajo do t'ish për mua urë shpëtimi. Pastaj liksht është për ty të kesh një xhaxha si mua? Pse qesh?

KARLLI

Si të mos qesh, more gargull[1] i gjorë? Munt të mos qesh me këto kombinezone[2] që bën ti?

FRANKU

Qesh sa të duash, un' e kam me gjithë mëndjen, harrin[3] të më dojë.

KARLLI

Ajo vjen të më bëjë bir me shpirt.

FRANKU

Dhe më mirë akoma, se do më kesh baba të thjeshtërt, edhe kështu do kem të drejtë të plotë të të heq nga ndo nj'herë veshin!

KARLLI

Mos na loth me të këtilla fjalë në kè Perëndi.

[1] gargull = Një fare shpendi ngjyrë verdhë, grurës (sepse lakmon grurin).
[2] kombinezon = kombinacione
[3] Harrin = mjafton që...

FRANKU

E sjell fjala.Munt të jetë edhe ndo një fat, ku ta dish. Neise, jemi d'akord, që unë do t'i mbaj me fjalë mysafirët që ju të kini kohë të llafosi me zojushat. Po edhe unë do fjalos me vejushen t'ënde.

KARLLI

Ç'ka e pranojmë.

SQENA 4

TË PARËT, BRASSET

JAKU

(*Dyke parë Brassetin që po hyn*)

He, djal' a çupë?

BRASSET

Djalë, djalë, urdhroni këndoni edhe letrën që më dhanë zojushat.

JAKU

Bravo, Brasset, i bëkërke paret! (*E çel letrën me nxitim dhe ze ta këndojë, po ja rëmben Karlli, të cilit ja rëmben prapë Jaku*). Prit, jahû, që të s'të durohet aspak!

KARLLI

Këndoje, këndoje shpejt.

JAKU

(*Mbassi këndon letrën*)

Po vijnë, po vijnë! ....

KARLLI

Të lumtë goja!

FRANKU

Kur vijnë?

JAKU

Për dy orë janë këtu.

FRANKU

Ahere paskam kohë kur të vinj. (*Fillon të dalë po Karlli e ndalon*).

KARLLI

Mos u ngut, mos u ngut. S'ke ku të vesh. Ti e di se nè s'e bëjmë dot pa ty. (*E unj poshtë Frankun*).

JAKU

(*Karllit*)

A je i sigurt se vjen sonte jot' emtë?

KARLLI

Plotsisht i sigurt, veç në i takoftë ndo një pengim. Ja, po nisem që tani të vete ta pres në stasjon (*Fillon të shkojë, po Jaku e ndal*).

JAKU

S'është nevoja të na lesh vetëm. Përse e kemi Frankun? (*Frankut*). Shko ti Frank në stasjon e na e bjerë këtu teton e Karllit.

FRANKU

Idè e mirë kjo. Ç'ka po shkoj unë.

KARLLI

Po ti s'e njeh personalisht.

FRANKU

Po as ti s'e njeh.Ç'del nga këjo? S'është ndonjë çudi, do t'a shoh që ësht' e huaj, do të vëshgëllonj, do ta pyes, do t'i rekomandohem e do t'ju a sjell të gjallë brenda në një karocë.

KARLLI

Me një veturë, thuaj. Ajo është koxha zonjë, s'të vjen me karocë.

FRANKU

Ç'ka ja u sjell edhe me veturë-taksi. Nem ahere nja 4-5 shilinga, se ti e di se jam rryp daulle.

KARLLI

(*Kërkon në për xhepet po s'gjen të holla*)

Medet, s'paskam të holla. Kè ti Jak?

JAKU

(*Kruhet, po s' gjen*)

As unë!

FRANKU

Po kur kini patur të kini edhe tashti? Ju jini drasë që të dy!

JAKU

(*I bërtet Brassetit*)

Brasset, Brasset .... (*Del Brasseti*)

BRASSET

Urdhro, zotni.

JAKU

Jepi Frankut nj' a 4-5 shilinga.

BRASSET

Ku t'i gjenj, zotni? Se mos m'i kini kthyer ato që ju kam hojtur?

JAKU

Pusho, s'dua fjalë. Jepi tani Frankut ato që të them dhe mbaj hesap.

BRASSET

(*I dëshpëruar nxjer e i jep Frankut 4 shilinga*)

Hej, taksirat! S'kam se ç'bënj! Urdhro, z. Frank (*Ja dorzon të 4 shilingat*).

JAKU

(*Frankut*)

Shko tashti shpejt në stasjon e na sill teton e Karllit.

KARLLI

(*Frankut*)

Mos u sill, si e ke zakon, se po të presim pa durim.

FRANKU

Mirë, mirë (*Franku del jashtë*).

SQENA 5

TË PARËT përveç FRANKUT

JAKU

Eja Brasset, mos rri si dru, se kemi punë sot. Pregatit shpejt gjellët bashkë me gjelltarin që kemi në kuzinë dhe sa të muntni hapni sytë që t'i kënaqim zojushat dhe teton e Karllit (*Brasseti del, por hyn prapë, tuke sjellë një telegram për Karllin).*

BRASSET

Një telegram, zotni Karll, urdhroni (*Ja dorzon*).

KARLLI

(*Tuke hapur e kënduar telegramin*).

Ah.... medet! ....

JAKU

Ç'pësove, jahu?

KARLLI

Na polli! Dona Luçija më telegrafon se po vjen javën tjetër!

JAKU

Po tani? Si t'ja bëjmë tani që na duhet me doemos një teto?

KARLLI

As unë s'e di! Hall i math ky! (*Mendohet*). Ha! .... E gjeta!

JAKU

Ç'farë gjete?

KARLLI

Mejtohem të zëvëndësojmë teton t'ime.

JAKU

Me cilën?

KARLLI

Gjeje në qofsh i zoti!

JAKU

Një qint vjet të mendohem s'e gjenj kurrë!

KARLLI

Me mikun t'onë Frankun!

JAKU

Je ndërmënt, apo të thres?

KARLLI

Mos u bëj merak, se e lot bukur këtë roll Franku. Kam edhe robat e reja të s'ime ëmë, që do t'i verë për bukuri, e mveshim si grua e kështu u a paraqitim zojushave si teton e Karllit! Si të duket ideja ime?

JAKU

Qënke dreqi vetë, po a e ke mejtuar mirë?

KARLLI

S'ka si bëhet ndryshe. Është nevoja të kemi një teto sonte, ndryshe zojushat s'të vijnë edhe puna jonë shkon për shëtitje, more vesh?

JAKU

Ke të drejtë. Po në mos dashtë Franku të përfaqësojë t'ët emtë?

KARLLI

Do ta përfaqësojë si Çelua, me hir, me pahir. E shtërngojmë ne. Pastaj mos kujto se Franku është një budallë, se do të përfitonjë edhe ay prej rastit, prandaj them se do të pranojë.

JAKU

Kam frikë se mos kemi avaze me Frankun.

KARLLI

Sa për Frankun ma lerë mua, se di se si ta kurdis.

JAKU

Bëj si të duash, veç puna të mbarohet (*dëgjohen këmbë në shkallët*). Dikush po vjen (*Sheh nga dritarja*). Po! Po! ....

KARLLI

Ç'pate?

JAKU

(*I dëshpëruar*)

Po vjen im' atë! .....

KARLLI

Tjetër bela këjo!.... Po kush dreqin i tha të vijë në këtë kohë? Tamam tani e gjet kohën edhe jyt atë të na vizitonjë? Po kij durim, mos u sëkëlldis se do t' ja gjejmë edhe këtij çarenë.

JAKU

Falemnderit fort e fort, Karll. Ti je ngushllim e mejlehm për mua.

SQENA 6

TË PARËT, FRANCESKU.

FRANCESKU

(*Tuke hyrë*)

Mirë se ju gjej zotninj (*E ze për dore Karllin dhe përqafon Jakun*). Si je, djali im, qysh të kam? Si shkoni? Si vini?

JAKU

Falemi nderit, baba. Kur paski ardhur?

FRANCESKU

Ardha me trenin e tashmë.

KARLLI

Mir se na arthtë ... Mua, më falni se kam pak punë. Flisni rehat çmallohi me mikun t'em të dashur Jakun (*Përshëndosh dhe del*).

SQENA 7

TË PARËT përveç KARLLIT

FRANCESKU

(*Tuke marrë një puro*)

Bah, bah, ç'po shoh këtu? Puro po pijni ju? Edhe ç'farë puro se, puro të Havanës, si do mos në këtë kohë kritike! Si kështu? Prandaj të mbarohen të hollat ty kaqe shpejt, e un' i ngrati

cigarisem[1] atje tej edhe kam prerë prej kohësh duhanin, si e si të të dërgonj ty të shkosh rehat, pa le të heq keq unë. Këjo qënka arësyeja që gjithënjë më kërkon të holla, e po më ve edhe borxhe, sa s'të arrin gjithë pensjoni t'em? Përhirimet e mija, djali im.

JAKU

Baba, çlodhu një herë, pastaj kemi kohë për këto. Pa ardhur mirë fillove të më qortosh?

FRANCESKU

Unë kam të drejtë, se ju të rinjtë bëni qejfe e pleqvet u pijen dhëmbët. Nuk është e drejtë këjo, djali im, mendoje mirë.

JAKU

Ma fal, baba, po mos kujto se do të t' i le këto pa shpaguar, kij vetëm pak durim, se nuk jam aq pamirënjohtës, sa më kujtoni.

FRANCESKU

Si do m'i shpërblesh gjithë këto sakrifica që kam bërë, më thuaj?

JAKU

Ja, qysh t'ja u them... (*Mejtohet pak*). Gjithë shpresën e kemi mvarur në një e emta e mikut t'em Karllit.

FRANCESKU

Nuk marr vesh ç'do të thuash.

[1] cigarisem = përvëlohem, digjem, zhuritem, tiganisem.

JAKU

Do ta merni vesh dhe pastaj do më jepni të drejtë, se ajo ësht'e pasur.

FRANCESKU

Ç'dolli nga ajo që qënka e pasur? Ç'më hyn mua në qese?

JAKU

Mos u nxitoni, baba, prisni pak t'ju shpjegohem. Tetua e Karllit është një grua pasanike, ose thuaj më mirë, milionare. Është e vehë dhe ka ardhur këtu që të martohet ....

FRANCESKU

He, pastaj?

JAKU

Them me mëndjen t' ime, se nuk do t' ju binte keq si kur ...

FRANCESKU

Sikur të martohesha me atë do të thuash... Ha, ha, ha.... Me atë mëndje vete? Përgëzimet e mija ahere.... Ç'thua, mor bir, unë të martohem tani në këtë kohë pleqërije, një plak oficer pensionist, a e kupton mirë se ku del këjo? Mezi që jetonj vetëm dhe ti kërkon të më hapësh avaze? Nuk më le rehat, them unë?

JAKU

Mos u mendoni ashtu, baba, ju s'jini plak akoma, s'kini mbushur të 60 vjetët. Shokët t'uaj martohen sot me duzina, edhe më pleq akoma. Dhe mos harroni se një martesë e këtillë na kishte për të shpëtuar nga gjithë hallet si mua ashtu edhe ju.

FRANCESKU

Gjetkë i shko këto fjalë, puna ime ka marrë funt qysh atë kohë, që humba të ndyerën t' ët ëmë. Tjetër grua s' e ze vëndin e saj.

JAKU

Si të doni pra, po e lemë këtë fjalë, mbasi nuk ju pëlqen. Po mos harroni, ju them, se tetua e Karllit, është një mi-li-o-na-re!

FRANCESKU

Pralla! Edhe milionarët kujton se po janë për dhëmbët t' ona?

JAKU

Pse jo? Mjafton të doni, e kemi ne në dorë ....

FRANCESKU

Qysh e paski në dorë? Do t'i imponoheni ju të më marrë mua? Ç'po flet ashtu, Jak, për kokën tënde!

JAKU

Unë e kam për një mënt. Ta besoni që ne e kemi në dorë, a më mirë të them, i nipi i saj Karlli, që do ta bënjë edhe bir për shpirt, e të jini të sigurt se Karllit ajo nuk ja prish qejfin kurrë.

FRANCESKU

Ç'më vure në një bela të madhe! Po më fut në zjar, djali im.

JAKU

Mos kujtoni se është një gjë e pa mundur këjo, baba, se unë besonj se nuk do gjente më të mirë se ty Dona Luçija Allvadores ....

FRANCESKU

Si e the, si e the? Pa ma thuaj edhe një herë.

JAKU

Do-na Lu-çi-ja Allva-do-res, prej Brezilit. Ka qënë e shoqja e milionarit Don Petro Allvadorësit të dëgjuar.

FRANCESKU

Tani e besonj se do të jetë vërtet pasanike, mbassi vjen nga Brezili (*Me vehte)*. Të them të drejtën nuk më mson për keq shejtani. S'është shaka të kesh të bësh me milionra ....

JAKU

Pse mendohi? Këtë rast nuk e gjeni kurrë, veç jepmani fjalën. Ku i latë plaçkat, valixat, baûllet?

FRANCESKU

Në hotel. Pse më pyet?

JAKU

Pse ju pyes? Natyrisht duhet të mvishi shpejt me robat më të mira, që të duki më i përshtatshëm e t'ju pëlqenjë Dona Luçija, kur t'ju shohë, se ajo do vinjë sonte këtu e do hamë darkën së bashkut. Shkoni, pra, shpejt e mvishi, se koha është flori!

FRANCESKU

(*Me vehte*)

Mir'e ka djali, (*Jakut*). Po shkonj, biri im, po shkonj të mvishem, mbassi t'u mbush mëndja të më martosh edhe nj' herë (*Del jashtë*).

SQENA 8

JAKU pastaj KARLLI pastaj FRANKU

JAKU

Sa shpejt u mbushet mëndja këtyre pleqve të martohen. U pëlqen shumë martesa më të ngrysur, e si do mos kur futen në mes milionat, sepse e kalojnë pleqërinë të ëmbël e të lumur. S' bëjnë edhe keq të ngratët!

KARLLI

(*Posa hyn*)

Ç'e bëre t'ët atë?

JAKU

Shkoj në hotel të mvishet me robat e mira, pastaj të vinjë këtu.

KARLLI

Pse ashtu?

JAKU

Ja mbusha mëndjen të martohet edhe një herë.

KARLLI

Folë mirë! .... Po me cilën?

JAKU

Ta merr mëndja ... Me cilën tjetër? Me teton tënde! (*qesh*).

KARLLI

Jahu, je ndër mënt? Kërkon të na ngatërosh pa ardhur mirë im'emtë?

JAKU

Po ta linja më tepër do më bënte rezil për plënkprishjen t' ime dhe për jetën luksoze që rronj, prandaj ja mbusha mëndjen për t'ët emtë dhe e përcolla shpejt.

KARLLI

Veç kij mëndjen e mos shko më gjattë.

FRANKU

(*Tuke hyrë me inat)*

Ardhi treni, po jot' emtë nuk e solli kokën. Nuk lashë vagon pa parë!

KARLLI

Ke të drejtë, Frank, mjerisht tani posa mora një telegram tjetër, që më thotë tetua ime se nuk vjen këtë javë.

FRANKU

Oh, sa keq! Ta dinja kështu të mos kisha shkuar ta pres. Shkuan kot të katër shilingat!

JAKU

Lijni tashti ato dhe mendoji si duhet të bëjmë kur të vijnë zojushat. Na duhet pa tjetër një teto (*I shkel synë Karllit*).

KARLLI

Duhet ta gjejmë pa tjetër.

FRANKU

Ku ta gjeni?

JAKU

Nuk ësht' e mundur të mveshim portjerën t'onë e t'ua paraqisim zojushave si teton tënde, Karll?

KARLLI

Ç'flet ashtu, Jak? Ajo shtrigane do të zerë vëndin e tetos s'ime?

JAKU

Po ahere?

KARLLI

(*Mejtohet)*

Ha! ... Më ra ndër mënt ....

FRANKU

Ç'farë?

KARLLI

Duhet të të mveshim ty, se vetëm ti munt ta lozësh atë roll.

FRANKU

(*E sheh me vërejtje e me kurrështim Karllin*)

Je tamam sot apo të kanë roitur[1] mënttë? Unë burrë të mvishem si grua? Ajo s'bëhet kurrë.

KARLLI

(*Frankut*)

Mos u bëj i keq tani, se nuk do pësosh gjë, pastaj edhe ne njerës jemi, nuk ta harrojmë kurrë këtë të mirë.

[1] roit = të ka ikur mendja, je i marrosur.

JAKU

(*Frankut*)

Mirë të thotë mos na prish qejfin tani

FRANKU

Mos ju prish qejfin? Edhe unë të bëhem paljaço për hatrin t'uaj? Më duket se edhe ti je eksiq nga mënttë! Më duket se që të dy jini për të lidhur sot! Mos kini ndërmënt të shkoni në çmendinë? Gati jam t'ju jap pasaportën[1].

KARLLI

Mos folë ashtu, Frank, se s' të kanë lezet ato fjalë!

FRANKU

Kqyr, kqyr paturpsi! Për Zotin qënki të marrë! Bre fyej, aqe ju a pret mëndja të mvishem si karnavale për hatrin t'uaj? Kërkoni të më poshtëroni që të mbaroni qëllimet t'uaja?

JAKU

Aman, Frank, mos bëj ashtu. Ti ke qënë kaqe i mirë për ne dhe tashti na mohon një shërbim kaqe të vogël?

FRANKU

I vogël ju duket ky shërbim që po më kërkoni? Ju do t'a bënit për mua një gjë të këtillë?

KARLLI me **JAKUN**

Pse jo?

FRANKU

Hej, dreq o punë, sa ngushtë më zunë djajtë!

[1] pasaporta = leje kalimi, "t'ju jap pasaportën" = "t'ju largoj"

KARLLI

Bëna kaqe të mire, Frank, se nuk ta harrojmë kurrë!

JAKU

Do të jemi mirënjohtës, për jetë dhe do të ta shpërblejmë.

FRANKU

E mora vesh! Paskam të bëj me dy të marrë! Ahere lamtumirë... (*Matet të shkojë, po Jaku me Karllin s'e lëshojnë)*

KARLLI, JAKU

Aman, aman, mos ikë!

FRANKU

Qysh? Do më shtërngoni përdhunisht?

KARLLI

Pafsh Perëndinë, Frank, do ta bësh këtë për ne, ndryshe jemi të humbur që të dy, si unë si Jaku. Aman (*I bijen më gjunjë që të dy)*.

FRANKU

(*I sheh në atë gjëndje dhe nënëqesh*)

Djalli ju martë, lugetë, më bindtë! ...Po, nuk më thoni, me ç'roba do më mvishni?

KARLLI

Mos u sëkëlldis për atë. Kam një palë roba të reja të së ndyerës mëmës t'ime që të venë extra. Me ato do të të mvesh.

JAKU

Karll, ngutu shpejt, të lutem, se nuk na pret koha, sepse zojushat janë në të ardhur e sipër.

KARLLI

(*E ze për krahu Frankun*)

Eja shpejt vllathi im, eja shpejt, se ashtu është puna, se nuk të lemë pa gjë edhe ty. (*Dalin jashtë të dy*).

SQENA 9

JAKU vetëm, pastaj BRASSET

JAKU

Plasëm gjersa e bindmë të mallkuarin! Prapë i zoti ka qënë Karlli, që ja mbushi mëndjen, edhe jam i bindur se këtë roll të tetos do ta lozë shumë mirë shejtani. Është dreqi vetë për kësij punësh. Për fat të mirë nuk e njohin edhe zojushat e kështu nuk do ta marrin vesh fjakën[1] (*Sheh nga dritorja*) Hë, hë... po vijnë edhe zojushat! (*Sheh mirë*) Tamam, ato janë... tani posa zbritnë prej automobili... Ato janë... Ketty me Anën! (*I bërtet Brasse-tit*). Brasset, Brasset! ....

BRASSET

(*Tuke hyrë me ngutsi*)

Urdhnove gjë, zotni?

JAKU

Shko shpejt e ju dil përpara zojushave, se ardhë. Shëko t' i preç mirë dhe drejtoji këtu. Hap sytë ....

BRASSET

Mos kij merak, zotni, sa për atë punë ma lijini mua. (*Del jashtë*).

[1] fjaka = dredhi, lodër.

SQENA 10

TË PARËT KETTY, ANNA

(*Trokasin që jasht*)

JAKU

Urdhroni, urdhroni, zojusha .... (*Ju çel derën*). Urdhroni ....

KETTY ANNA

Ha! .... Mirë se ju gjejmë. (*Përshëndoshen*)

JAKU

Ju lumtë këmba që arthtë. Ardhja juaj na nderon tepër, falemnderit (*Ketty e Anna unjen në fronat)*

ANNA

Ku është zotni Karlli?

JAKU

Shkoi gjer në stasjon të presë teton e tija, Donën Luçija Allvadores që po vjen sonte nga Brezili.

ANNA

Oh, sa embër i gjatë, po thuaj se pesë metro i gjatë ....

KETTY

Vjen tani, apo do vonohet?

JAKU

As pak, zojushe, kudo që të jetë këtu e kemi sonte.

ANNA

Shumë mirë. Do kemi nderin t'a njohim edhe ne.

JAKU

Prandaj edhe ju ftuam për darkë.

ANNA, KETTY

Falem nderit shumë.

JAKU

Nuk ju pyeta, zojusha, si ju dha lejën kujdestari juaj z. Spetting?

ANNA

Për fat, kujdestari jonë shkoj sot për në Edimburg për disa punë private e kështu ishim krejt të lira, kur na ftuat ju.

JAKU

Oh, sa mirë, si do mos do kemi kohë të fjalosemi gjër' e gjattë.

SQENA 11

TË PARËT, KARLLI, FRANKU

(*mveshur mirë si grua e me një ventalje në dorë hyjnë brenda)*

JAKU

O, urdhroni, urdhroni, e mirë se na arthtë.

KARLLI

(*U rekomandon të gjithëve Frankun, si Donën Allvadorès)*

Zojusha, ju presentonj teton t'ime, Dona Luçija Allvadorès nga Brezili.Teto, ju paraqit zojushat Anna Spetting e Ketty Verdom, miqeshat t'ona. Jak, tetua ime, zonja Allvadorès; teto, miku im i dashur, z. Jak Tsesney (*Përshëndoshen*).

ANNA, KETTY

(*Frankut*)

Gëzohemi shumë që po ju njohim.

FRANKU

Edhe unë jam tepër i ... e kënaqur, që po ju shoh. Oh, sa të mira qënki që të dyja! (*I rrok për qafe e i puth).*

JAKU, KARLLI

(*Nga dale, tuke e cimbisur*[1] *Frankun*).

He, he, ç'bën ashtu?

FRANKU

(*Nga dale Jakut e Karllit*)

Mos më cëmbisni kështu mos harroni se jam tetua e Karllit!

KETTY

(Tuke i dorëzuar Frankut një tufë lule)

Urdhro, zonjë, këto lule.

FRANKU

Falem nderit shumë. (*Tuke sulmuar ta puthë prapë, e ndalon Jaku*)

[1] cimbis = pickoj.

JAKU

(*Nga dale Frankut*)

Morè i mallkuar a je ndër mënt? Ç'bën kështu?

FRANKU

(*Gjithashtu Jakut*)

Do më lijni rehat të bënj detyrat e tetos, apo jo? Ju e kini fajin që më mveshtë më këtë ditë, tani rijni urtë.

KETTY

Si i kini shkuar udhës Dona Luçija?

FRANKU

Shumë bukur, zojushe, veç se udha ka qënë e gjatë shumë.

ANNA

Si e kaloni kohën në Brezil?

FRANKU

Mjaft mirë, zojushe, se me të vërtet si Brezili, si Rio de Janeiro s'ka në Botë.

KARLLI

(*Nga dale Frankut*)

Hap sytë mirë mos na tradhëtosh.

FRANKU

(*Nga dale Karllit*)

Nuk më thua, a kam fëmijë?

KARLLI

(*Gjithashtu*)

Ke pasur, po tani s'ke, dhe do më bësh mua djalë.

FRANKU

(*Nga dale Karllit*)

Si e quanin burrin t'em?

KARLLI

(*Gjithashtu*)

Don Pedro.

FRANKU

(*Karllit, nga dale*)

Kur më ka vdekur?

KARLLI

(*Gjithashtu*)

Ka nj'a pesë a gjashtë vjet.

KETTY

(*Frankut*)

Kishit ndo një punë këtu në Londër?

FRANKU

(*Karllit nga dale*)

Si t'i përgjigjem tani?

KARLLI

(*Gjithashtu*)

Thuaji ç'të të vijë ndërmënt.

FRANKU

(*Kettyt*)

Kam ardhur për të larë.... ca tesha....

KARLLI

(*Nga dale Frankut*)

Bretku[1]! Ç'flet ashtu, bre buf i kënetës? (*Kettyt*) Zojushe, tetua ime është shumë shakaxhesë. Kur ju thotë se ka për të larë ca tesha, duhet të merrni parasysh, se kërkon të thotë se, do të lanjë ca hesape, që i kanë debitorët e ndryshmë, e sidomos banqerët.

FRANKU

Po, tamam, kam për t'u larë kokrat banqerëvet! (*Qeshin të gjithë*)

KARLLI

(*Frankut nga dale*)

Mos lojte mëntsh sot? Ç'janë këto që po thua? (*Kettyt*) Kërkon të thotë tetua se do t'i qërtonjë mjaft, që nuk i kanë larë hesapet prej kaqe kohësh.

ANNA

(*Frankut*)

Zoti Karll do të jetë shumë i gëzuar që ju pa, Dona Luçija.

FRANKU

Edhe unë jam gëzuar shumë që e pashë. Karlli ka karakterin e s'ime motre..

KARLLI

(*Nga dale Frankut*)

E t'im vëllajt, thuaj.

[1] Bretku = i shastisur, hutaq.

FRANKU

Po, karakterin e s'ime motre që ja përngjiste t'im vëllajt.

KARLLI

(*Nga dale*)

Mos folë budallallëke.

FRANK

(*Nga dale Karllit*)

Budallë je ti, që s'më msove që më parë!

KETTY

E kini djalë prej motre Karllin, Dona Allvadorès?

FRANKU

Po, po, ime motër edhe unë ishim... motra. Karllin e kam si djalë.

ANNA

Sjelljet t'uaja, zonjë, kundrejt zotit Karllit më bëjnë t'ju çmoj shumë.

FRANKU

Falem nderit. Po të më njohnje më mirë do më çmoje më tepër.

KARLLI

(*Nga dale, tuke cëmbisur Frankun, i cili thret, oh, oh, oh)*

Kij pak turp, ç'jan ato që po flet?

FRANKU

(*Nga dale Karllit*)

M'i bëre mishrat plagë. Po të më cimbisësh edhe një herë do t'i nxjer sheshit të gjitha!

ANNA

Më duket si kur kam nënën t'ime përpara, zonja Luçija, aqe ju dua.

FRANKU

Edhe unë, moj bija ime, të dish sa të dua! Pse s'më hidhesh për qafe, kur më do kaqe fort?

ANNA

Pse jo? (*Sulet ta përqafojë po Karlli e tërheq Frankun*)

KARLLI

(*Frankut nga dale*)

Do të rish urtë apo ç'thua?

FRANKU

(*Karllit*)

Jam teto, mos harro. S'munt të sillesh ndryshe?

KARLLI

(*Annës*)

Kini kohë kur të përqafohi. Tani të pregatitemi për darkën se tetua ime është shumë e lodhur.

KETTY

(*Frankut*)

Shumë gjëra të mira na ka treguar z. Karll për ju.

FRANKU

(*Kettyt*)

Edhe unë, zojushe, nuk ta rrëfenj sa jam e gëzuar që ju shoh sot, aqe sa më vjen t'ju shtërngonj e t'ju puth...(*Çohet e e përqafon Kettyn, tuke e puthur*).

JAKU

(*Frankut nga dale*)

Bre maskara, ç'bën ashtu?

FRANKU

(*Kettyt*)

Të kam si çupën t'ime.

JAKU

E di vetë Perëndija. (*Frankut nga dale*) Po e përsërite edhe një herë do na marrë djalli, po të them.

FRANK

(*Nga dale Jakut*)

Do rish urtë, apo t'i heth poshtë fustanet e t'ju bënj qepaze të gjithve?

SQENA 12

TË PARËT, FRANCESKU

FRANCESKU

(*I mveshur bukur e me një trëntafil në butonjerë)*

Ha! Ç'po shoh këtu?

JAKU

(*Nga dale Franceskut*)

Kij mëndjen të sillesh mirë (*Me zë*) Baba, po ju paraqit fisniken zonjë Luçija Allvadorès, teton e Karllit. Dona Luçija, ju rekomandonj babanë t'em, z. Francesko Tsesney.

FRANCESKU

Oh, sa gëzohem që po ju njoh, e ndershmja zonjë.

FRANKU

(*I cili s'e njeh Franceskun*)

Ç'dreqin na u fut ky në mes? (*Franceskut*) Edhe unë jam gëzuar zotni, që ju njoha.

JAKU

Baba ju presentonj zojushat Anna dhe Ketty, miqeshat tona; zonjusha im atë, zoti Francesko Tsesney (*Përshëndoshen*).

ANNA dhe **KETTY**

Kënaqemi tepër, zotni.

FRANCESKU

Edhe unë mjaft, zojusha.

JAKU

Baba im ka ardhur, zojusha, rastësisht të na vizitonjë.

FRANCESKU

(*Nga dale Jakut, tuke parë me vërejtje Frankun*)

Qënka mjaft e bukur tetua e Karllit dhe mjaft e re për mua. Ah, si kur ta mernja grua, sa i lumtur do t'isha!

JAKU

(*Nga dale Franceskut*)

Mos u ngut, se mos na prishësh punë.

FRANKU

(*Tuke parë trëntafilin në butonjerën e Franceskut*)

Oh, sa i bukur trëndafil e sa mirë që ju vete!

FRANCESKU

(*Më vehte*)

Duket se fillova t'i pëlqenj që tani! Shënja të mira këto! (*Frankut*). Ju pëlqen, Zonjë? Më jepni lejën t'ju a jap?

FRANKU

Jo, jo, falem nderit, mirë e kini ju, munt t'i mar vetëm erë, po të më lejoni.

FRANCESKU

Me gjith qejf (*Ja ve trëndafilin në hundë Frankut, i cili i merr erë*).

FRANKU

Oh, sa er' e këndëshme!

FRANCESKU

(*Me vehte*)

Më duket se ma vuri synë! Aqë më mirë për mua!

JAKU

(*Nga dale Frankut*)

Mjaft fole tani. Lerju radhën edhe të tjerëvet.

KARLLI

(*Frankut nga dale*)

Merre shpejt z. Francesko dhe shkoni nga kopshti të na lijni dhe ne rehat të llafosemi me zojushat.

JAKU

Merre për krahu, babë, Donën Allvadorès dhe shëtitni pak në kopsht.

FRANCESKU

Shumë bukur (*I ofron krahun Frankut, i cili e pranon*). Eja, zonjë bujare të shëtisim (*Më vehte*) Sa mirë, që do kemi kohë të fjalosemi gjër' e gjattë! (*Francesku me Frankun dalin jashtë*).

SQENA 13

TË PARËT përveç FRANCESKUT e FRANKUT

JAKU

Tani, zojusha, jemi vetëm e munt të flasim lirisht.

KARLLI

Këtu as na sheh, as na dëgjon njeri.

ANNA

Ç'të flasim? I kemi folur të gjitha. Po të jini të zotët të merni pohimin e kujdestarit t'onë, ne s'kemi as një kundërshtim të fejohemi me ju, si unë, si Ketty.

KETTY

E kemi në vënt të babajt e s'munt t'i dalim përpara.

KARLLI

Tani që ardhi edhe tetua ime, besojmë se diçka do bëhet.

JAKU

Dhëntë Zoti e martë funt kjo çështja jonë, si dëshërojmë ne.

SQENA 14

TË PARËT, SPETTING

SPETTING

(*Tyke hyrë me zembrim u adresohet zojushavet*).

Këtu më qënki ju? Bravo! Ju paska shumë hije, dy zojusha me dy burra kokë mbi kokë! Nuk më thoni, nga e muart lejen, që ardhtë këtu që të dyja? (*U sillet Jakut e Karllit*). Po, ju, zotrinj, si kuxuat e i ftuat për darkë mbesat e mija, pa u marrë vesh me mua?

JAKU

Na fal, sir Spetting, po me rastin që na urdhroj këtu tetua e Karllit që po vjen nga Brezili, i ftuam zojushat që të njihen me këtë zonjë, që quhet DONA LUÇIJA ALLVADORES dhe është një zonjë aqe fisnike sa s'bëhet.

KARLLI

Do ta kini dëgjuar, zotni Spetting, Donën Allvadorès, që është një grua e mbaruar, sa edhe milionare!

SPETTING

Milionare? Si the, milionare?

KARLLI

Mi ... li ... o ... na ... re! Kur ta shihni edhe ju do ta besoni.

SPETTING

Ashtu? Po, ahere ku është tetua juaj ta njoh edhe unë? (*Më vehte*). Po të më pëlqente munt ta kërkonja edhe për grua!

JAKU

Në doni ta njihni urdhroni poshtë nga kopshti, ku po shëtit.

SPETTING

Ahere, me lejen t'uaj, po shkonj t'a njoh (*Del jashtë*).

SQENA 15

TË PARËT përveç SPETTINGUT

JAKU

Shpëtuam me kulaç për brezi nga ky qerver[1]!

KARLLI

E çporrmë qafet me një mënyr të bukur!

ANNA

Na shpëtoj Zoti prej ndo një skandalli!

KETTY

U menduat mirë që i vutë përpara teton e Karllit.

JAKU

Këta pleqtë gënjehen shpejt pas milionavet.

KARLLI

Ku e kishim fjalën?

[1] qerver = taksirat, qeder.

JAKU

Në pikën e fejesavet e pastaj të martesavet.

KETTY

Ju thamë se, pik së parit duhet të merrni pohimin e tytorit t'onë, pastaj ne jemi d'akord bashkë.

ANNA

Nga ne s'kini as një kundërshtim.

SQENA 16

TË PARËT, FRANKU

FRANKU

(*Hyn me ngutësi, tuke marrë erë shpejt e shpejt me ventaljen*)

Uf! Plasa! (*Shtrihet mbi një kanape*)

KARLLI

Ç'pate, teto?

FRANKU

(*Nga dale Karllit*)

Ç'të kem? Edhe më të kem? U gjeta në mes të dy zjarevet! (*Të gjithë qeshin*). S'ishte mjaft një, po na edhe një tjetër! Njëri me msyri me mitroloza, tjetri me artileri të rëndë... S'kisha nga të ruhesha e nga t'ja mbanja! Më dolli shpirti! ... Më mbroni, ju lutem, jam një burrë...një grua e pafuqishme! S'dinja i ngrati, ha... pardon, e ngrata, si të bënja, se nuk jam msuar të abllokohem[1] kaqe ngushtë! Ata qënkeshin të këqinj që të dy, më kër-

[1] të ablokohem = të bllokohem, të gjëndem, të rrethohem

cenin përsipër si dy gjela! (*Fillon të qanjë dhe ngreh fustanet të fshinjë lotët, por fillojnë me një herë t'i duken pandallonat*).

KARLLI

(*Me ngutësi ja unj fustanet dhe i flet nga dale Frankut*)
T'u mbylltë dera ç'vajte të na bësh! Kij mëndjen tjetër herë!

JAKU

Paske gjetur belanë, Dona Allvadores!

KARLLI

He pastaj si u bë, tetua e dashur?

FRANKU

Ika e i lashë të grihen në mes të tyre!

JAKU

(*Karllit*)
Ahere shkojmë t'i ndajmë

KARLLI

Shkojmë ... (*Të gjithë dalin jashtë*)

Bije napa.

FUNT I AKTIT TË I-rë

AKT II

(Sqenari si edhe në aktin e parë)

SQENA 1

BRASSET, pastaj JAKU, KARLLI

BRASSET

(*Tuke ndrequr fronat*)

Kam parë djaj, po jo si këtë të paudhin Frankun! Kaqe bukur e lot shejtani rollin e Donës Luçija Allvadorès sa të bën të fikesh gazit! Sa herë që e shoh, edhe vetëm sa e shoh, më hipën një e qeshur sa s'mbahem dot! Po ajy i mallkuari nuk qesh aspak. U a mori mëndjen edhe Franceskut edhe Spettingut. I tërboj që të dy pleqtë. Kush e di sa herë janë kapur fyt për fyt e janë kërleshur për hatrin e Frankut, edhe ky tallet me ata! Po e kanë fajin edhe milionat, që ata kujtojnë se i ka Franku, si Frank të këput shpirtin; s'ka para as për një paqetë cigaresh. He, si kur ta dijnin plakoshët e shkretë se Dona Luçija është burrë... Dikush po vjen... Ha, qënka zotnija vetë. Po ajy tjetri? Ha, tamam, qënka zotni Karlli (*Jaku me Karllin hyjnë brenda pa vënë re Brassetin*).

JAKU

More, a e din se do gjejmë belanë me këta pleqt' e çmëndur? S'i ndahen s'at' emte as njëri as tjetri!

KARLLI

Si domos Spettingu ja ka vënë shumë syrin. Po ne duhet ta rrejmë këtë pas s'im' emte, gjer sa t'i shkëputë fjalën që t'ju japë leje zojushave për të fejuar me ne.

JAKU

Franku është një kopil kopili, sa për atë. Besonj ta bindë Spettingun.

KARLLI

Edhe unë ashtu them, po t'i mbushi mëndjen atij plakut tënt që t'ja lerë fushën e lirë atij dudukut[1] tjetër Spettingut. Jepi të kuptojë se Dona Luçija nuk është tamam grua si e kujton yt' atë.

JAKU

Sa për atë ma lerë mua, ti veç kurdise mirë Frankun të mbarojmë shpejt punë, sa pa marrë vesh dredhinë.

KARLLI

Nuk të thashë ç'na ka bërë i mallkuari në sofër, Franku dua të them, se e kisha pranë.

JAKU

Si? Pa folë

KARLLI

Ajy cëmbiste zojushat, atë e cimbisnin pleqtë, që e kishin marrë në mes, mos e pyet hallin! Po edhe Franku s'binte poshtë. Kush e di sa herë u a dogji duart me cigaren e tija. Pa le që u a dërmoi gjunjët e këmbët e shkreta së shkeluri e së shkelmuari!

JAKU

(*Tuke parë Brassetin*)

Ti ç'punë ke këtu? Mos na përgjon se ç'flasim njëri me tjetrin?

[1] duduk = njeri i trashë nga mendja

BRASSET

Jo, Zotni, po qesh me vetvehten.

JAKU

Mos qesh për teton e Karllit?

BRASSET

Po për cilën tjetër? Çuditem si e lot kaq mirë rollin e tetos.

JAKU

Ajo është puna jonë, ti mos u bëj merak, shëko punën tënde.

BRASSET

Ke të drejtë, zotni, se zotrote nuk ishe poshtë në kopsht të shëkonje se ç'ngjiste midis Frankut edhe pleqve të tjerë.

KARLLI

Si, si, pa na thuaj.

BRASSET

Njëri e ndiqte këtej, tjetri andej, Franku ....

JAKU

(*I pret fjalën*)

Dona Luçija, thuaj.

BRASSET

Dona Luçija nuk dinte nga të futet. Tamam si kur ishe në ndo një lëmë, ose në ndo një çirko, ku bëhen vrapet?

KARLLI me **JAKUN**

(*çkulen së qeshuri*)

Pastaj?

BRASSET

Bënin si kuajt kur shijnë. Ç'pësuan lulet e bimët e gjora nuk ka si tregohet!

JAKU

Qysh, qysh? Më shkelnë lulet e kopshtit që i ruanja si të dy sytë?

BRASSET

Mjerisht, zotni, kopshti i juaj ka marrë formën e luadhit, ose të lëndinës. Nuk njihet se ka qënë ndo një herë kopsht!

JAKU

(*I dëshpëruar*)

Medet ç'më gjet!

KARLLI

Leri tani lulet, pa ke kur t'i vajtosh.

JAKU

Pse brithnin ashtu si të marrë?

BRASSET

Se gjithkush prej pleqvet e desh për vehte Donën Luçija, e cila tuke u mbrojtur, njërin e qëllonte me tufa lulesh, tjetrin me tufa ferrash, dikur u hidhte dhè ose baltë, edhe dikur e qëlloj Spettingun me një garbë[1] me lule!

JAKU

Jazëk, më shkoj edhe garbja me lule, që e kisha dhe bojatisur!

[1] garbë = vazo, sidomos prej balte për lule

KARLLI

Pusho edhe ti, se s'u bë kijameti për një garbë! Po të më bënjë dhëndër Spettingu t'i shpaguaj të gjitha.

JAKU

Në atë krah të flesh. Më duket se kot po mundohemi.

KARLLI

Mos e thuaj atë fjalë. Të jesh i sigurt se Franku do na mbaronjë punë. Do bëjë si do bënjë, do ta futë në thes Spettingun.

JAKU

Sa për mua, unë e kam prerë shpresën që tani. Le kopshti që më shkoj po më shkoj kot edhe darka, që do bënj kush e di sa kohë ta ve në vënt gjithë këtë harç që bëra.

KARLLI

Mos i hith armët kaqe shpejt. Kij pak durim, po të them.

JAKU

Ti po sheh ëndra, më duket

KARLLI

Ëndra sheh ti jo unë. Un' e kam tamam. Do ta shohsh *(Brassetit*). Ti Brasset shko shpejt e na pregatit katër çaje, se do vijnë tani zojushat ta pijmë çajin bashkë.

BRASSET

Me gjith qejf, zotni Karll, po s' ka çaj.

KARLLI

Të vesh të blesh.

BRASSET

Me se? Duhen të holla.

JAKU

Paguaj ti dhe mi zerë në hesap.

BRASSET

Gjer kur do vazhdojnë këto hesape, zotni?

JAKU

S' dua shumë fjalë. Shko atje ku të thashë.

BRASSET

Deh, or hall deh, se si do bënj as unë s'e di (*Del jashtë*).

SQENA 2

TË PARËT, përveç BRASSETIT

JAKU

A e sheh si katandismë? S'kemi të holla as për një çaj!

KARLLI

Mos u bëj evgjit: Sa më tepër të kursesh, aqe më keq shkon puna.

JAKU

Kush të tha se kursenj? Unë po të them se s'kam as metalik[1]!

[1] metalik apo metelik = Monedhë e vjetër turke prej metali, pare.

KARLLI

Nuk u bë kijameti për një çaj.

JAKU

Ahere pse nuk harxhon zotrija jote?

KARLLI

Më di që të kem e nuk harxhonj? Un jam krip' e Stragës në këtë pikpamje më për zi se ty!

JAKU

Pikëpamje delikate këjo. Ahere merre pas vehtes tënde dhe mos ngut të tjerët.

KARLLI

Për një çaj të shkretë sillesh kështu? Turp për një Tsesney!

JAKU

Si lum ti, Karll. Desha të rronj me këto ëndrat e tua!

KARLLI

Tani këto fjalë s'bëjnë pare. Më mirë të mos humbasim kohën. Ti Jak qëndro këtu, se unë po shkoj të mar zojushat të pijmë çajin.

JAKU

Bëj si të duash (*Karlli del jashtë)*

SQENA 3

JAKU pastaj FRANCESKU

JAKU

Çudi bënj me ca njerës si Karlli, që s'e çajnë kokën as pak. Edhe s'kanë edhe duan të mbahen kryenaltë! Kësaj i thonë "dhi e zgjebosur e bisht përpjetë"!

FRANCESKU

Vetëm qënke, Jak?

JAKU

Vetëm, ejani.

FRANCESKU

Djali im i dashur, ja ku po të çfaqem tani haptazi. Mora një vendim të prerë, definitif.

JAKU

Ç'farë vendimi?

FRANCESKU

Vendosa të martohem me teton e Karllit.

JAKU

(*Me vehte*)

Ruajna, o Zot! (*Franceskut*). Për një mënt e ke?

FRANCESKU

S' kam nevojë të të gënjenj.

JAKU

Është e pamundur këjo që thua!

FRANCESKU

Qysh e pamundur? Harrove ç'më the më parë, që duhet të martohem me Donën Luçija Allvadorès?

JAKU

Është punë që s'bëhet!

FRANCESKU

Pse? Mos ndryshove mëndje?

JAKU

Ndryshova mëndje, se e pashë që ajo nuk të dashuron!

FRANCESKU

Kush të tha? E ke gabim! Nuk e pe si më afroheshe? Nuk e pe si i mbajti erë trëndafilit t'em?

JAKU

Kot e kini, baba, tetua e Karllit më duket se dashuron më tepër z. Spetting!

FRANCESKU

Të dinjë ç' kemi folur e sa i kemi ofruar punët! Mjafton të hap gojën unë edhe puna është e mbaruar. Pastaj mos harro se bëhet mirë edhe për ty, si thamë. Dona Luçija është shpëtimi jonë!

JAKU

Baba, ju thashë se është punë që s' bëhet ajo.

FRANCESKU

Pse kështu? Si ndryshove me një herë? Pa ma shpjego më mirë.

JAKU

Ja, si t'ju them, ... (*Me vehte*) ky paska lojtur mëntsh sot!...

FRANCESKU

Folë, pse përtypesh?

JAKU

Ju thashë, është punë që s'bëhet, s'bëhet, s'bëhet!

FRANCESKU

Kqyr, kqyr si flet!... Duket se di ç'ka do kesh marrë vesh e s'do të ma rrëfesh. Mos ka ndo një pikë të errët, ose ndo një njollë jeta e saj, shpjegomu më mirë ta mar vesh.

JAKU

Ku ta di unë?

FRANCESKU

Ke ndo një dyshim? Kë dëgjuar gjë?

JAKU

(*Me vehte*)

Ky kërkon të mi nxjerrë me darë (*Franceskut*) Ku munt t'a dijni një grua, që ka rrojtur kaqe vjet e lirë e e vehë në Brezil e si domos e zonja e kaqe miljonrave?

FRANCESKU

(*Me vehte*)

Nuk e ka keq i shkreti djalë! Unë këto s'i mendova (*Jakut*). Po si duhet të bënj tani unë, një ushtar i vjetër, a duhet të kthenj

nga fjala? Është turp për mua. Prandaj, jam mejtuar të martohem një herë me atë, edhe po të mar vesh gjë mbi kurizin e saj, ahere e ndanj me një herë!

JAKU

(*Me vehte*)

Tani më zuri ngushtë. (*Franceskut*) . He, po në qoftë se ajo nuk ju do, ahere si bëhet? A munt ta marrësh tjetrën me pahir?

FRANCESKU

Këjo ndryshon, po unë me sa kam kuptuar, s' jam i gënjyer, se Dona Allvadorès më dashuron me të vërtet, veç se na ra më qafë ajy i urgjisuri Spettingu, po, si e vura re, Dona Luçija e përbuzi atë shumë keq, prandaj them, se preferencën e ka mbi mua. Pra, djali im, mundesh të më fatmirosh qysh tani ... He, ç'thua?

JAKU

(*Me vehte*)

S'është punë t'ja shkul mëndjen që ka për... Frankun e shkretë, me gjithë që e di se Franku do ta sjellë në vënt.

FRANCESKU

Folë, po të pres.

JAKU

Ç'ka kemi kohë kur të fjalosemi për këtë çështje.

FRANCESKU

Ahere unë po shkonj të pjek të dashurën Donën Allvadorès (*del*).

SQENA 4

JAKU pastaj KARLLI, BRASSET

JAKU

Po humbas mëndjen! Ç'është këjo që na polli! Duhet folur me Frankun për ç'ngjet, që të marrë masat t'a largonjë.

KARLLI

(*Hyn tuke gulçuar*)

A do ta bësh terbjet atë maskaranë Frankun?

JAKU

Ç'ngjet prapë? Mos bëri ndo një marrësi tjetër?

KARLLI

Ma ka zaptuar Anën dhe gjithë po shetisin bashkë krah për krah në kopsht dhe shpesh herë e përqafon i mallkuari!

JAKU

I shkreti Karll! Po se mos nuk ma punon edhe mua me Kettyn, si ty me Annën? A thua t'u themi çupave se ky i paudhë është burrë e jo grua si e kujtojnë, që të mos pësojmë ndo një gjë më të madhe?

KARLLI

Edhe ajo na duhet. Në bëfshim një gjest të këtillë ahere falimentuam, të jesh i sigurt. Pra, duro të durojmë.

JAKU

Ti, a e di se ç'po bën ky plaku im?

KARLLI

Ç'farë?

JAKU

U prish mëntsh pas tetos t'ënde, Frankun, edhe e kërkon për grua me do e mos. Kam rënë në pikën e hallit dhe nuk ja mbush dot kokën që të heqë dorë. Ma tha sheshazi dhe nuk ndryshon taktikë!

KARLLI

Asaj ja gjejmë ilaçin, po ti shëko mos na prishet puna jonë.

BRASSET

(*Tuke hyrë*)

Ku dëshëroni ta pijni çajin?

KARLLI

Bravo, Brasset! E pata harruar çajin, se ky Jaku ma turbulloj mëndjen.

JAKU

(*Brassetit*)

Mbaje në zjarr çajin, pa të them unë se kur të na servirç (*Karllit*). Shkojmë të gjejmë zojushat (*Dalin të gjithë*).

SQENA 5

FRANCESKU, SPETTINGU

FRANCESKU

(*Tuke hyrë*)

S'paska njeri këtu? Ç'u bë Dona Luçija? Ajo më caktoi të piqemi këtu. Mos e mora vesh gabim?

SPETTING

(*Tuke hyrë*)

Ç'u bë Dona Allvadorès? Ajo më tha se do bashkohemi këtu. S'paska ardhur akoma, po, më duhet ta pres (*Unjet*).

FRANCESKU

(*I del përpara*)

Ç'urdhrove zotrote?

SPETTING

Po zotrote ç'kërkon këtu?

FRANCESKU

Unë kam djalin t'em këtu edhè jam në shtëpinë t'ime.

SPETTING

Edhe unë kërkoj mbesat e mija këtu, që si duket, u kanë marrë mënttë djali yt me atë shokun tjetër.

FRANCESKU

Ajo është pun' e tyre.

SPETTING

As pak e tyre, po imja (*Me vehte*). Si t'i thom këtij shtrigut, që m'u sheshua këtu, që s' dua t' i çfaq shkakun e vërtetë?

FRANCESKU

(*Me vehte*)

Ç't'i përgjigjem këtij qesharaku, që paska vënë në butonjerë trëntafilin t'im, që ja dhashë Donës Allvadorès? (*Spettingut*). Nuk më thua të drejtën, pse more mundimin e ardhe gjer këtu?

SPETTING

Ta thashë. Në daç më çkoqur, po të them se kisha pjekje këtu me fisniken zonjë Luçija Allvadorès, e cila m'u premtua...

FRANCESKU

(*Me vehte*)

Ç'thotë ky i marrë? Ësht' e mundur Dona Luçija të na ketë caktuar pjekje që të dyve këtu? Nuk më vjen ta pranonj kurrë, që ajo zonjë të denjojë të hedhë sytë mbi këtë shtrembanik!

SPETTING

Tani që ju tregova shkakun e vërtetë të ardhjes s'ime këtu, munt të më thoni edhe zotrija juaj pse u munduat gjer këtu?

FRANCESKU

(*Me një krenari*)

Edhe unë kam pasur pjekje me Donën Allvadorès.

SPETTING

Bravo! Surrat që ka pëlqyer Dona Luçija!

FRANCESKU

Mos surrati yt është më i mirë? Nuk sheh se po të bijen edhe flokët edhe dhëmbët akoma ty gërmuq?

SPETTING

Merre fjalën prapa, Dona Luçija është për dhëmbët e tua!

FRANCESKU

As për të tuat, më duket!

SPETTING

Laje gojën kur flet për mua!

FRANCESKU

Laje ti, jo unë!

SPETTING

A munt të më qërohesh që këtej?

FRANCESKU

Munt të qërohesh ti, jo unë. Unë jam në shtëpinë t'ime.

SPETTING

Mjaft të durova, del jashtë shpejt! (*Fillon ta shtyjë*).

SQENA 6

TË PARËT, JAKU KARLLI

JAKU, KARLLI

(*Tyke hyrë*)

He, he, ç'bëni kështu? Turp! (*Fillojnë ti ndajnë*)

FRANCESKU

Nuk shihni me ç'farë paturpësi kërkon të më dbojë nga shtëpija ime?

SPETTING

(*Jakut*)

Lidhe këtë se qënka për në çmendinë!

KARLLI

(*Nga dale Spettingut*)

Mos bëni kështu, jahu, s'ju ka lezet!

JAKU

(*Franceskut*)

Të lutem, baba, mbaj qetsinë, se do na prishësh punë.

FRANCESKU (*Jakut*)

Ç'farë punet? Ke ndo një punë me këtë farë kopuku?

JAKU

(*Nga dale Franceskut*)

Një punë me shumë rëndësi.Ta them pastaj.Po tani mbahi, sa të mundni, e mos prishni gjakun (*Spettingut*). Sir Spetting po ju rekomandonj babanë t'em, z. Francesko Tsesney.

SPETTING

Ky është babaj yt? Ahere më vjen keq për sa ngjanë midis nesh (*Franceskut*). Zotni Tsesney, ju kërkoj ndjesë (*E ze për dorë*).

FRANCESKU

Uj' e kripë sa folmë në mes t'onë. (*E ze gjithashtu për dore*).

JAKU

(*Nga dale Karllit*)

Ç' patnë që u kërleshnë këta të dy?

KARLLI

(*Nga dale Jakut*)

Nuk të ra ndër mënt? Janë rivalë që të dy për teton t' ime ... Frankun (*Qeshin*).

JAKU

Kush e di ç' u ka punuar ajy i mallkuar, Franku!

KARLLI

(*Nga dale*)

Do ta marrim vesh edhe këtë.

SQENA 7

TË PARËT, FRANKU, ANNA, KETTY
pastaj BRASSET

FRANKU

Hyn brenda, tuke patur për krahu nga njëra anë Annën dhe nga tjetra Kettyn)

Ha! ... Këtu qënki të gjithë?

KETTY, ANNA

Ho! .... Ungji jonë këtu?

SPETTING

(*Me inat Kettyt e Annës*)

Ku jishit ju gjer tani që po ju kërkonja?

ANNA

Kemi qënë bashkë me Dona Luçija Allvadorès.

KETTY

Ah, xhaxhaj im, sa e mirë që është Dona Allvadorès.

SPETTING

(*Nënëqesh*)

Thashë se mos ishit vetëm, po tani më bëhet qejfi shumë se paski shëtitur bashkë me zonjën fisnike Allvadorès. (*Me vehte*) Sa mirë do ishte si kur ta kishin teto me të vërtet!

FRANCESKU

(*Me vehte*)

Tamam, pse është kaqe e mirë do ta marr unë grua!

JAKU

(*Tuke cëmbisur Frankun, nga dale*)

Ku ishe, bre lugat?

FRANKU

(*Nga dale Jakut*)

M'i bëre plagë mishrat, jahu, në vënt të më jesh mirënjohtës. Unë përpiqem për ju dhe ju më bijni kot më qafë! Kam faj unë që po sakrifikohem për ju kopukë! Aqe më vjen, sa t'i flak përtej këto fustane, që më bënë **rezil**! (*Ze të çvishet*).

KARLLI

(*Tuke e ndaluar*)

Aman, për kryet t'ënt, mos bëj ashtu se na fike! (*Jakut nga dale*) Nuk të thamë se do t'ja durojmë të gjitha këtij dreqi gjer sa të mbarojmë punë? Kij edhe pak durim.

JAKU

(*Nga dale Karllit*)

Po nuk e pe me ç'farë paturpsi hyri këtu, tuke i pasur për krahu që të dyja çupat?

KARLLI

(*Nga dale Jakut*)

Do të durojmë se s' kemi ç'bëjmë.

FRANCESKU

(*Tuke iu afruar Frankut*)

Si ju duket Londra Dona Luçija?

FRANKU

S’e kam shijuar akoma, kur t’a shoh do t’ju them përshtypjet e mija.

SPETTING

(*Tuke ju afruar Frankut*)

Tani do t’ju mbajmë këtu, e dashura Dona Allvadorès, s’ju lëmë të ikni.

FRANKU

(*Nga dale Spettingut*)

Po të rijni urtë do qëndronj, ndryshe ika.

SPETTING

(*Nga dale Frankut*)

Jo, aman, mos e thuaj atë fjalë.

JAKU

(*Nga dale Frankut*)

Jepi të kuptojë t’ im ati se ti nuk je për atë!

FRANKU

(*Nga dale Jakut*)

Ti mos u bëj merak, ajo është puna ime.

KARLLI

(*Nga dale Frankut*)

Hap sytë mirë e mos ju ndaj Spettingut. Përpiqu t'i marrësh lejën për të dy zojushat.

FRANKU

(*Nga dale Karllit*)

Flije mëndjen se s’ indahem gjer sa ta bint.

FRANCESKU

(*Nga dale Frankut*)

Ah, ëngjëlli im!

SPETTING

(*Nga dale Frankut*)

Ti je gjithë Bota për mua!

FRANKU

(*Nga dale Spettingut*)

Aman, mos më expozo, se kemi kohë kur t'i flasim këto fjalë (*Jakut nga dale)*. T'ët atë do ta le të shëtisë, e sa për këtë tjetrin do ta prish mëntsh gjer sa t' i mar pohimin.

JAKU

(*Nga dale Frankut*)

Po të na mbarosh punë do të shohsh sa do bëjmë ne për ty. Veç o burra, mos lerë kusur.

BRASSET

(*Tuke hyrë*)

Urdhroni, zotrinj, të katër çajet janë gati.

JAKU

(*Brassetit*)

Të katër çajet të bëhen shtatë.

BRASSET

(*Nga dale Jakut*)

Po unë s'kam pregatitur më tepër se katër zotni, ku t'i gjenj paret e tjera edhe për tre çaje akoma?

JAKU

(*Nga dale Brassetit*)

Fjalë të shkurtra, të kam thënë. Mbaj hesap, edhe më në funt i paguajm të gjitha.

BRASSET

(*Ze kryet me të dy duart*)

Eh, o Perëndi, gjer kur do vazhdojë kjo?

JAKU

(*Brassetit*)

Këtu je akoma? Gremisu shpejt!

BRASSET (*Me vehte*)

Edhe këjo na lipsej, të paguash nga xhepi edhe të të çporrin me shkelmë! Shumë bukur, për Zotin! (*Del jashtë*).

FRANCESKU

(*Nga dale Frankut*)

Dona Luçija ime, unë të gjeta ty, si gjen Bedujini një lule në mes të shkretëtirës.

FRANKU

(*Nga dale Franceskut*)

Edhe unë të rastisa, si rastis udhëtari një kërcu në mes të rrugës! (*qesh*)

SPETTING

(*I cili i dëgjon*)

Ho, ho, ho, dush! (*Fërkon duart*).

FRANCESKU

(*Frankut*)

Jam kapur pas tejet si kapet i mbyturi pas një drase në mes të detit, ku sheh shpëtimin e tij.

FRANKU

Edhe drasa është gati t'ju lerë të fundosni!

SPETTING

Folë, folë, të lumtë goja! .... Ho, ho, ho, sa më bëhet qejfi!

JAKU

(*Nga dale Franceskut*)

A e sheh mirë se nuk të do?

FRANCESKU

(*Nga dale Jakut*)

Unë jam ushtar i vjetër, djali im, edhe nuk i shmangem kurrë fortesës gjer sa ta gadhnonj[1]!

JAKU

(*Nga dale Franceskut*)

Po fortesa më duket se është prej çelnikut e kam frikë mos thyeni hundët!

SPETTING

(*Me vehte*)

Pa dale ta provonj edhe unë.(*I afrohet Frankut*) Unë, Dona Luçija, jam si një shtegtar i etuar që gjeta një krua përpara meje. A kam të drejtë të pi ujë nga ky krua?

FRANKU

(*Spettingut*)

Të pish sa të ngjinjesh kur e ke kruan pranë.

[1] gadhnoj = pushtoj

SPETTING

(*Nga dale Franceskut*)

A e sheh dhe vetë sa më dashuron? (*Frankut*) Ju falem nderit fort, Dona Luçija. E ndjenj vehten si kur se jam në Parajsën e vërtetë, si duhet të bënj?

FRANKU

Duhet të gëzohesh e të dëfrehesh sa të mundësh.

SPETTING

(*Nga dale Franceskut*)

A e pe tani cilin preferon prej të dyve?

FRANCESKU

(*Nga dale Spettingut*)

Kam frikë se mos mbetesh me gisht në gojë. (*Frankut*). Dona Allvadorès, do më bënit më të lumturin e gjithë njerësvet, po të pranonit dorën t'ime!

FRANKU

(*I zembruar*)

Uh, edhe ti nuk më le rehat? Jam kaq i..., e turbulluar sa nuk munt ti duronj këto fjalë! (*Bën si kur i bije të fikët*).

FRANCESKU

(*I çqetësuar sulet e ze të mos rëzohet*)

Ujë shpejt, se i ra vilanija!... (*Frankut*) Qysh? Ma pretë krejt shpresën?

FRANKU

Pushoni, në daçi Perëndinë. Nuk e kuptuat se zembra ime reh për një tjetër?

SPETTING

(*Nga dale Franceskut*)

U binde tani? Nuk të thashë unë se ajo më dashuron vetëm mua dhe as një tjetër?

ANNA

(*Tuke e tërhequr Frankun*)

Eja me ne ....

KETTY

Gratë duhet të jenë me gratë ....

FRANKU

Ashtu është e vërtet, të dashurat e mija! (*I rrok që të dyja për qafe kurse Jaku me Karllin e tërheqin)*.

JAKU, KARLLI

(*Nga dale Frankut*)

He, he! ....

FRANKU

(*Tuke mos i vënë re*)

Bijat e mija, shtërngoni teton t'uaj! (*Anna dhe Ketty sulen të përqafojnë Frankun, po Jaku me Karllin e tërheqin prapë*).

JAKU

(*Nga dale Frankut*)

Bretku, i mallkuar!

KARLLI

(*Gjithashtu*)

Maskara!

BRASSET

(*Tuke hyrë*)

Çaji është gati zonja e zotërinj, urdhroni... (*Të gjithë çohen. Franku rëmben të dy zojushat, Jaku t'atin dhe Karlli Spettingun dhe shkojnë në odën tjetër të gjithë).*

SQENA 8

DONA LUÇIJA, EMMA, pastaj BRASSET

LUÇIJA

(*Tuke hyrë me Emmën*)

Qysh bëhet të banonjë këtu nipi im Karlli? Duket se jeton bashkë me ndo një kolegun e tij, se unë këndova në derë një kartvizitë ember mbiembrin JAK TSESNEY. Këjo, Emma ime, më kujton një histori të vjetër dhe nuk di a ka të bënjë ky embër me një TSESNEY tjetër, që jam njohur dikur në Monte-Karllo! (*Sheh andej këtej*) Salon i bukur ky edhe i mobilluar mirë!

EMMA

Duket se yt nip Karlli nuk ju priste sot, prandaj nuk e pamë në stasjon të na dalë.

LUÇIJA

Ka pasur të drejtë djali, se unë i hoqa telegraf të dytë që nuk vinj, po pastaj ndrova mëndje e u nisa. Desha t'i bënj një **surprizë**. (*Shtrihet në një kanape*). Jam pak e lodhur prej rruge ... Të thashë se kam një nip shumë të mirë e të sjellë, e jam e sigurt se po ta njohësh do ta pëlqesh edhe ti, edhe s' është çudi të të martonj me atë.

EMMA

(*Unj kryet*)

Si të doni, zonjë, jam e juaja tani.

LUÇIJA

Mos më quaj zonjë që këtej e tutje. Të më threç "teto" si më thret edhe Karlli jem.

EMMA

Ç'ka ashtu qoftë, do t'ju thres "teto".

LUÇIJA

Më pate thënë dikur se kishe dashuruar një djalë, a nuk ma përsërit edhe një herë t'a dëgjonj? A e dashuron akoma?

EMMA

Po, e dashur teto, ësht' e vërtetë që pata njohur dikur një djalë tepër të mirë e fisnik, të cilin edhe e kisha dashuruar, po mjerisht nuk qëndroj shumë kohë me ne dhe s' di se ku shkoj, se as që më tha, e kështu, kaluan tash kaqe vjet që po e kërkonj e s' e gjenj dot.

LUÇIJA

Kush ishte ay e si quheshe?

EMMA

Ishte një student nga Oksfordi, një djalë shumë fisnik, i pasur tjetër herë, po kur e njoha unë ish i vobektë. Na mbante shoqëri për dita kur ish gjallë edhe im' atë, po ay u largua dhe babaj më vdiq e kështu mbeta jetime. Babaj e desh shumë dhe dëshironte të më martonte me atë, se edhe ay më desh, po për fat të keq iku!

LUÇIJA

Ashtu më ka takuar edhe mua bija ime. Kam njohur në Monte-Karllo një djalë të ri, një toger engles të kavalerisë, me të cilin piqeshim shpesh herë në Kazino. Mua më pëlqente fort, por ay ish i turpshim dhe nuk kuxonte të më çfaqeshe, kështu që, as unë as ajy nuk muntmë të çfaqim ndjenjat t'ona dhe dashurija jonë falimentoj, po munt të të them se unë edhe sot nuk e kam harruar, me gjithë që shkuan kaqe vjete që s'e kam parë.

EMMA

Po pse s'e kërkove më von?

LUÇIJA

Se ay mori një urdhër urgjent të shkonte në Hind me regjimentin e tij. Qysh ahere s'ja kam ndjer zënë, me gjith që e kam kërkuar nga të katër anët e dheut!

EMMA

Si e kish embrin?

LUÇIJA

E quanin FRANCESKO TSESNEY dhe prandaj, si e pe e si të thashë, u habita tepër, kur pashë ne porta atë kartvizitë me emrin JAK TSESNEYT!

BRASSET

(*Tuke hyrë sheh befas Luçinë dhe Emmën*)

Ha, pardon!... Zotrija juaj kur paski ardhur këtu? Cilat jini, ju lutem?

LUÇIJA

Këtu banon z. Karll Whitegham?

BRASSET

Si urdhron zonjë, banojnë bashkë me zotninë t'em, z. Jack Tsesney.

LUÇIJA

Jak Tsesney? Nuk më thua, biri i kujt është ky z.Jak Tsesney?

BRASSET

Ësht' i biri... i biri ... (*Mendohet*) .... i z. Francesk Tsesneyt.

LUÇIJA

(*Nga dale Emmës*).

Tamam, i biri i atij që të fola gjer tani! Çudi! (*Brassetit*). Z. Karll Whitegham ku është?

BRASSET

Ndodhet në atë dhomën tjetër, zonjë, tuke pirë çajin me shoqëri.

LUÇIJA

Ësht' e mundur t'i thuash të vinjë pak këtu?

BRASSET

Për cilën kam nderin t' i them që e kërkon?

LUÇIJA

Mjafton t'i thuash se e kërkon një zonjë e ardhur së largut. Po, të lutem, ja thuaj si më njanë mos e dëgjonjë tjetërkush.

BRASSET

Shumë mirë, zonjë, po ja them. (*Me vehte*) Qënka e çuditshme këjo! Cila do jetë vallë? (*Del*).

LUÇIJA

Tash kam për të marrë vesh nga i biri i tij, në rron i ati i tij, ajy i ëndëruari im, Francesko Tsesney.

SQENA 9

TË PARËT, KARLLI

KARLLI

(*Tuke hyrë*)

Me cilën kam nderin të flas?

LUÇIJA

Nuk më njeh, Karll? Jam tetua jote Luçija Allvadorès!

KARLLI

(*I gëzuar e rrok për qafe*)

Mirse na ardhe e dashur teto, që po të prisnim si ujin e ftohtë! Po zojusha tjetër kush është?

LUÇIJA

Është bija ime e adoptuar, Emma Brown; z.Karll Whitegham (*Përshëndoshen që të dy Karlli me Emmën).*

LUÇIJA

Nuk më prisnje sot, Karlli jem, se me të vërtet do nisesha pas një jave, mbassi të hoqa telegramën e parë, po pastaj ndro-

va mëndje dhe u nisa me një herë që të të bënj një surprizë. Po, me cilët je m'at' anë?

KARLLI

(*Me vehte*)

Si t'i them tani, që m'at' anë kemi edhe një tjetër psefto[1] Dona Luçija Allvadorès! (*Luçisë*) Jemi me ca miq e po pijmë çaj.

LUÇIJA

Nuk munt t'i sjellësh që të gjithë këtu të njihemi?

KARLLI

Si të urdhroni (*Me vehte*). Ah, si të bënj tani që më zuri ngushtë!

(*Luçisë*) Do t'i sjell këtu me gjithë qejf, po vetëm ju lutem, mos u çfaqni cila jini, se ashtu është puna.

LUÇIJA

Pse ashtu, ngjet ndo një myster?

KARLLI

Dua të mos marrë vesh njeri se zotrote je tetua t'ime, sepse ju dijnë që jini pasanike, e kështu, për shumë arësyje më mirë mos çfaqeni

LUÇIJA

Ha, ha, tani e kuptova, ke të drejtë.

KARLLI

Janë edhe disa arësyje të tjera, të cilat ja u them më von.

[1] psefto = rrenë, gënjeshtër, pseudo.

LUÇIJA

Ç'ka djali im, do bënj si që më këshillon.

KARLLI

Ahere unë po shkonj e po i sjell të gjithë këtu.

LUÇIJA

Po ju pres (*Karlli del*).

SQENA 10

TË PARËT dhe GJITHË TË TJERËT

KARLLI

(*Tuke hyrë i shoqëruar prej të tjerëve e le enkas prapa Frankun që të mos e shohë Dona Luçija, e i presenton kësaj të tjerët*)

Z. Spetting, zojushat Ketty e Anna, zoti Jak, zoti Francesko Tsesney. Zojusha e zotërinj, ju paraqit zonjën Mabel Thomson dhe zonjushen Emma Brown, dy miqeshat t'ona.

(*Pershëndoshen të gjithë njëri me tjetrin*).

LUÇIJA

(*Karllit nga dale*)

Pse më rekomandove me embër tjetër?

KARLLI

(*Ngadale Luçisë*)

Do t'ju a them pastaj arësyjen.

LUÇIJA

(*Nga dale Emmës*)

E dëgjove kush ish ay që po rri atje tej? Është z. Francesko Tsesney, për të cilin të fola gjer tani. Pra, qënka këtu.

(*Ndërkohë Franku vjen nga dale e qëndron pa u rekomanduar afër Emmës*).

LUÇIJA

(*Karllit*)

Cila ishte ajo zonjë, që s'ma rekomandove? (*rëfen Frankun*)

KARLLI

(*Nga dale Luçisë*)

S'e njoh as unë, se pse ardhi këtu me zojushat që po shihni.

EMMA

(*Nga dale Luçisë*)

Këjo zonjë që ardhi tani (*tregon Frankun*), më duket se është një fytyrë e njohtur.

FRANKU

(*Me vehte*)

Nuk e di ku e kam parë këtë zojushe! (*Flet me Emmën*) Kam frikë se mos është ajo që kam njohur dikur!

SPETTING

(*Nga dale Frankut*)

E kuptova e dashura ime, se sa shumë interesoheni për mua, prandaj dëshironja të flisnim pak veçanërisht. Ç'thoni?

FRANKU

(*Nga dale Spettingut*)

Me gjithë dëshirë, po të lutem, kij pak durim, dhe në qoftë e mundur, largoji pak zojushat dhe Karllin e Jakun se nuk dua të na marrin vesh ç'flasim, se më vjen turp.

SPETTING

Ju, zotrinj Karlli e Jak dhe zojushat Ketty e Anna, munt të na lijni pak vetëm, tuke shkuar në dhomën tjetër, se dëshirojmë të fjalosemi pak në mes t'onë (*Jaku, Karlli, dhe Ketty e Anna shkëmbejnë nga një bisht syri në mes tyre, kërkojnë lejën dhe dalin jashtë*).

SQENA 11

TË PARËT përveç JAKUT, KARLLIT,
KETTYT e ANNËS

LUÇIJA

(*Spettingut*)

Zotni Spetting, nuk ma rekomanduat akoma këtë zonjë këtu (*tregon Frankun*), që të kem nderin t'a njoh edhe unë.

SPETTING

Ha, pardon, Zonja Thomson ma falni. Ju rekomandonj fisniken Dona Luçija Allvadorès (*Frankut*). Zonja Thomson.

LUÇIJA

(*Frankut*)

Gëzohem fort. Ju paraqit edhe unë mbesën t'ime, zojushen Emma Brown

FRANKU

Gëzohem tepër.

LUÇIJA

(*E habitur, më vehte*)

Ç'dëgjova? Embrin t'em po e sjell kjo zonjë? Mos jam në ëndër? Këtu di ç'ka ngjet, po do ta shohim.Duket se është ndo-

një lojë, prandaj më rekomandoj me tjetër embër im nip e më porositi të mos çfaqem.

EMMA

(*Nga dale Luçisë*)

Qysh, e dashura teto, paska edhe tjetër Dona Allvadorès? Kjo është një çudi e madhe!

LUÇIJA

(*Nga dale Emmës*)

Hesht, bija ime, mos folë gjer sa të shohim fundin (*Frankut*). Ju lutem, zonjë, ç' farë fisit e kini zotni Karllin?

FRANKU

E kam nip, zonjë.

LUÇIJA

Ha, e paski nip! Ahere z. juaj do jini pa fjalë e vehja e të ndyerit Don Piedro Allvadorès nga Brezili, s' është ashtu?

FRANKU

(*Tuke u përtypur*)

Si urdhron, zonjë (*Me vehte*). Sa kam frikë se mos ngatrohem.

LUÇIJA

Dëshironja prej vjetesh, zonjë, t'ju njihja, se pse kemi patur miqësi të ngushtë me të ndyerin Don Piedro. Që kur ndodheni në Londër?

FRANKU

Sonte kam ardhur, zonjë.

LUÇIJA

(*Me vehte*)

Tani do të të ze në preshtë! (*Frankut*). Sa më vjen keq që e humptë kaqe shpejt burrin t' uaj të dashur, që ishte aqe i mirë!

FRANKU

Se mos desha unë? Ato janë punët e Perëndis! (*Me vehte*) Dreqi ta martë ku ma solle kokën! Për fat të keq nuk ndodhet afër edhe ay i mallkuari Karlli të më msonte si ti përgjigjem kësaj dose!

LUÇIJA

Ishte shumë i sjellë i ndyeri Don Piedro!

FRANKU

Po, si urdhroni. (*Duhet ti them ndo një hollësi tjetër që të më zerë besë që jam vërtet e shoqja e Don ... dreqit*)! (*Luçisë*). Vetëm që kish ca zakone të këqija i ndyeri ....

LUÇIJA

Ç'farë zakone?

FRANKU

Ishte pak ziljar e më bënte shumë vërrejtje, sa m'u mërzit jeta!

LUÇIJA

(*Me vehte*)

Uh, i marsh të keqen atij farë burri! Sa gënjen!

FRANKU

(*Franku merr yrysh*)

Ishte dhe pak .... teknefès[1]!

LUÇIJA

Teknefès? ... Ha, sa për këtë kini gabim shumë! Don Pedro ish kaq i zgjuar, sa e kishin zili gjithë shokët!

FRANKU

(*Me vehte*)

Medet, më zuri ngushtë! (*Luçisë*) Dua të them se ishte pak si i lënë, si t'ju them ....

LUÇIJA

As pak i lënë, e kini shumë gabim. Duket se s'e kini njohur mirë!

FRANKU

Ndofta ke të drejtë, po ashtu më dukej mua. (*Me vehte*) Ah, Karll, Karll ç' më bëre, që s'të kam këtu!

LUÇIJA

Mos kishte edhe ndo një cen tjetër?

FRANKU

(*Me vehte*)

More, këjo po m'i qit me darë! Ç't'i them tjetër? (*Luçisë*). Ishte dhe mjaft ... pijanèc ....

LUÇIJA

Pijanèc Don Piedrua? Ruajna, o Zot! Ajy s'vinte as verë në gojë, zonjë si qënka pijanèc? Bënj çudi me ju!.... Sa fëmijë kishit?

[1] teknefes = njeri që i merret fryma, asthmatik, por dhe "i humbur", "budallë"

FRANKU

(*Me vehte*)

Po tani? .... Dreqi të martë na ngatërove krejt! (*Luçisë*). As unë s' mbanj mënt sa fëmijë kishim.....më duket se nja 4 a 5, s'di as unë, se e kam harruar krejt!

LUÇIJA

(*Me vehte*)

Morë, gënjeshtra me bisht, kur se s'kishim as një fëmijë! (*Frankut*). Po ku i kini tani këta fëmijë?

FRANKU

(*Me vehte*)

Uf, plasa!.... Shumë më ra më qafë kjo shtrigane! Si t'i them tani? (*Luçisë*). As unë s'e di se ç'u bënë, po më duket se kanë vdekur që të gjithë! (*Matet të shkojë*). (*Me vehte*). S'durohet më!

SPETTING

(*Frankut*)

Ku po shkoni, Dona Allvadorès? (*Nga dale Frankut*). Rri pafsh Zotin, mos ikë. Këjo e mallkuar s'na lè radhë të llafosemi!

FRANKU

(*Nga dale Spettingut*)

Po të rri edhe pak do prishem mëntsh!

SPETTING

(*Nga dale Frankut*)

Ahere qëndro këtu, se po shkonj unë dhe ti me marifet tërhiqesh më von e zbret në kopsht, ku po të pres, (*Të tjerëvet*). Mua më falni pak, se po ju lè vetëm, se kam ca punë (*del*).

FRANCESKU

(*Me vehte*)

Mezi na u shpor qafet ky arrakat!

LUÇIJA

(*Franceskut*)

Zotni Tsesney, kisha një fjalë me z. t'uaj.

FRANCESKU

Urdhroni, zonja Thompson.

FRANKU

Ahere ma falni mua t' ju lè vetëm të fjaloseni. (*Ze të ikë*).

EMMA

(*Tuke e ndaluar*)

Ju lutem, zonjë, qëndroni pak, se kam edhe unë një fjalë me ju.

FRANKU

Bah! .... (*Me vehte*) Edhe këjo paska fjalë me mua? Më duket se diku e kam parë këtë fytyrë! (*Emmës*). Ahere po qëndronj, zojushe.

EMMA

Falem nderit fort.

LUÇIJA

(*Frankut e Emmës*)

Ma falni pak se do flasim veçanërisht me z. Tsesney. Munt të flisni edhe ju nga ana tjetër (*Tërhiqet me Franceskun pak mê tutje gjithashtu tërhiqen edhe Franku me Emmën)*

EMMA

Dona Luçija Allvadorès, a më njihni mua?

FRANKU

(*E sheh i habitur*)

Më duket, zojushe, se di ku ju kam parë, por do kenë kaluar vjete e s' më bije ndër mënt.

EMMA

Jemi njohur, më duket, në Nicë bashkë.

FRANKU

(*Me vehte*)

O Perëndi, të jet' ajo, vallë, që njoha e që dashurova në Nicë, e bija e Hary Brownit? (*Emmës*). Mundet, zojushe.

EMMA

Po personi që njoha unë në Nicë ishte një djalosh e jo një grua, si po ju shoh ju. Ajy quhej Frank Baverley, student i Mjekësisë.

FRANKU

(*Çohet më këmbë i enthusuasmuar*).

Tamam, unë jam i tëri! Ti zojushe mos je Emma e Hary Brownit?

EMMA

Unë jam! A je ti Franku? (*Tepër e gëzuar*). O Zot ku të rastisa.

FRANKU

Ah, ç' fat ishte ky që na poqi prapë, e dashura ime! Aman bëj pak durim gjer sa të mbaronjë kjo komedi e t'i heq këto fustanet!

EMMA

(*Tuke qeshur*)

Ç'është shkaku që je mveshur më këtë ditë?

FRANKU

Mos e pyet hallin; po lozim një fjakë me rëndësi, por po, ta them pastaj. Po, si kështu? Kur paske ardhur? Si u ndodhe me këtë zonjë?

EMMA

Edhe unë do t' ju shpjegohem më von, kini durim.

FRANKU

Sa mirë do t' ishte si kur të delnim pak nga kopshti të fjaloseshim çngjeshur. Si thua dalim?

EMMA

Pse jo (*Luçisë*). E dashur teto, më jepni pak lejën të shetisim pak me zonjën Allvadorès? (*I shkel syrin Luçisë*).

LUÇIJA

Ç' ka, munt të shetisni (*Franku me Emmën dalin jashtë*).

SQENA 12

TË PARËT, përveç FRANKUT EMMËS,
pastaj BRASSET.

FRANCESKU

Ku shkuan, zonjë, Dona Allvadorès me mbesën t'uaj?

LUÇIJA

U dhashë pak lejën të shetisin, që kështu të mbetemi edhe ne vetëm e të fjalosemi më mirë.

FRANCESKU

Shumë mirë. Tani jam në dispozicjonin t'uaj.

LUÇIJA

Pa më shëkoni mirë në sy, zoti Tsesney, a më njihni?

FRANCESKU

(*E kqyr me vërejtje*)

Më vjen se jemi parë diku, se fytyra e juaj më ngjan një fytyrë e mirënjohtur, po s'mbanj mënt ku jemi takuar.

LUÇIJA

Nuk më thoni, a e kishit njohtur një toger kavalerije me emër z. Franz Tsesney?

FRANCESKU

Po unë jam, moj zonjë! Po ju cila jini, ju lutem?

LUÇIJA

Tani do më njihni më mirë, se duket se më harruat krejt! A mbani mënt kur u nistë për në Hind me regjimentin t'uaj? A mbani mënt një zojushe atë natë në ballo, me të cilën kërcyet disa herë edhe ajo ju çfaqi një sympathi të madhe, si edhe ju asaj? Po zotrote ike ditën tjetër e kështu s'pattë kohë të merreshit vesh më mirë. Ajo zojushe zotni s'ju ka harruar aspak dhe po ju dashuron akoma. Pra, unë jam Luçija Thomson, që më von u martova me Don Piedron në Brezil e sot jam e vehë, nënë embrin e burrit t'em Don Piedro Allvadorès!

FRANCESKU

(*Tepër i habitur*)

Ti je Luçija? Oh, sa i lumur jam që po të shoh edhe një herë pas kaqe vjetsh (*Përshëndoshen*).

LUÇIJA

Sa u dëshpërova, se nuk gjenja dot adresën tënde, u shtërngova e u martova me të ndyerin Don Piedro Allvadorès dhe sot jam e vehë!

FRANCESKU

Ahere zotrote qënke e vërteta Dona Luçija Allvadorès e jo ajo zonjë që kam njohur gjer tani?

LUÇIJA

Si urdhron.

FRANCESKU

Tetua e z. Karllit?

LUÇIJA

Ajo e tëra!

FRANCESKU

Po ajo zonja tjetër, që sjell po embrin t'uaj cila duhet të jetë?

LUÇIJA

Edhe unë s' e marr vesh, prandaj po habitem tepër ç' ngjet këtu!

FRANCESKU

Do ta shohim dhe këtë se ku do dalë. Po nuk më thoni, a jini akoma në atë mendim që ishit edhe në Nicë atë natë?

LUÇIJA

Unë nuk kam ndryshuar mendim, me gjithë që kaloj një kohë e gjatë.

FRANCESKU

Falem nderit shumë. Këjo më bën të lumtur, por, mjerisht, nuk ju a fsheh, se unë sot jam një pensionist fatkeq, që rronj vetëm me një rrogë të vogël, me të cilën mbanj edhe t' ëm bir, e këjo më dëshpëron!

LUÇIJA

Atë mos e mejtoni as pak. Kam unë për ju të dy.

FRANCESKU

(*Krejt i enthusiasur*)

Po ahere qënkam më fatmiri njeri i gjithë Botës! Ti qënke urë shpëtimi për ne, e dashura Luçija! (*Çohet e përqafon por në atë çast hyn Brasseti me një dhisk me filxhanë me çaj tuke parë Franceskun e Luçinë në atë gjendje, bërtet një* ***ha!****... dhe gremiset poshtë me gjithë filxhanët me çaj të cilët bëhen copë*).

FRANCESKU

(*Brassetit*)

Ç'pate, jahu? Ti na trembe shumë!

BRASSET

S'di si më ardhi!... Më ra të fikët! (*Me vehte*). More paturpësi!

FRANCESKU

Po, zararin që bëre kush e paguan?

LUÇIJA

S'ka gjë e paguanj unë (*Nxjer e i jep një napolon Brassetit*). Na, janë paguar, besonj, të gjitha.

BRASSET

(*Tuke parë e fërkuar sytë, me vehte)*

Sa bujare qënka shtriga! (*Luçisë*). Falem nderit fort, zonjë.

LUÇIJA

(*Brassetit*)

Dëgjo, ç'pe këtu do t'i lesh këtu, se unë kam për ta shpërblyer më mirë këtë shërbim, more vesh?

BRASSET

Mos kini merak, zonjë, se unë jam një pus i thellë për kësij punësh. Por, mbase thatë se do më shpërbleni për kësij mundimesh fshehtësija ësht' e mundur të fillojë qysh tash kjo kujdesija juaj?

LUÇIJA

Ah, shejtan, shejtan, sa i zgjuar që je! (*Nxjer prej kuletës e i jep edhe dy napolona të tjera)*. Na .... i ke mjaft këto për tani.

BRASSET

(*Tepër i kënaqur*)

Ju falem nderit tepër, fisnikja zonjë! (*I puth dorën*). Tani po ju le të lirë dhe në daçi po ju mbyll edhe derën së jashtmi mos ju besdis njeri, dhe kur të dëshëroni më trokisni që t'ju a hap (*Del jashtë*).

FRANCESKU

Ahere, Luçija ime e dashur, qysh tash të konsideronj t'imen e u trashëgofshim e... sa për të mplakur, nuk është nevoja të zgjatemi.

LUÇIJA

Edhe unë jam jotja me mish e me shpirt! (*Përqafohen të dy*).

Bije napa

FUNT I AKTIT TË II

AKT III

(Sqenari i theatrit si edhe në aktet e tjerë)

SQENA 1

JAKU, KARLLI, FRANKU

JAKU

(*Frankut*)

Nuk them se nuk e lot mirë rollin t'ënt, po nda ndo një herë i jep lumën edhe na zembron, se bën ca budallallëqe që s'durohen!

FRANKU

Budallallëqe që ju puth çupat t' uaja?

KARLLI

Tamam! Pun' e vogël të duket këjo? Edhe bile përpara nëve?

FRANKU

Më duket se sot s'jini tamam as njëri, as tjetri! Ore buffë, po, si ësht' e mundur një teto të mos puthë mbesat, ato që do t'i bënjë mbesa? Ç'dashuri munt të tregojë një teto, pa i puthur mbesat? Ejani ndër mënt! Pastaj ç'punë kini ju me gratë? Nuk jam grua unë kështu si më mveshtë ju?

JAKU

Jè një maskarâ! (*qesh*)

FRANKU

Unë, apo ju? Bravo, kemi dhe fjalë...s'më lijni me gjithë hallet, them unë? S'kini faj ju, fajin e kam unë, që po vepronj pas qefeve t'uaj, pastaj jam edhe maskarâ! Të kini turp, turp!

KARLLI

Mos harro se na dhè fjalën se do na mbarosh punë.

FRANKU

Se mos më lijni ju rehat ta mbaronj? Ju më cëmbisni e më shkelmoni, sa ma bëtë trupin vula vula! Nuk më thatë të bënj ç'të mundem, mjafton të mbaroni qëllimet t'uaja? Tashti ç'janë këto fjalë? Po të m'a përsëritni edhe një herë do të çvishem... ja ... (*Ze të çvishet*).

KARLLI, JAKU

Aman, aman, veç asaj!

FRANKU

Ahere rijni urtë... do t'i puth sa të dua! S'pranonj ndër-hyrje!

KARLLI, JAKU

Bëj si të duash!

JAKU

Vetëm mos i puth shumë.

FRANKU

S'ka shum' e pak këtu, do t'i puth sa të dua, ju thashë, doni a jo?

KARLLI

Mirë, mirë ....

JAKU

Me masë ç' do gjë ....

FRANKU

S' ka masë e kut në këto çështje. A e dijni se qënki teknefeza që të dy? Ore garguj, ku është dëgjuar që një teto të mos puthë mbesat? Jini ndër mënt, apo t'ju çonj që të dy në çmentinë?

JAKU

Bretku i paudhë!... Leri këto fjalë tani e na thuaj përfundimet.

FRANKU

Ashtu thuaj të të ketë hije. E, dëgjo, pra: T'yt ati i dhashë të kuptonjë se duhet të presë krejt shpresën për mua dhe e binda....

JAKU

Bravo!

FRANKU

Sa për Spettingun, e kam kurdisur kaqe mirë, sa po ju siguronj se sonte pa fjalë dot' i marr pohimin, bilè me shkrim që t' u japë lêjën zojushave të martohen me ju ....

KARLLI

Bravo!

FRANKU

(*Tuke parë nga dritorja*).

Medet, po vjen dashnori im ....

KARLLI

Cili dashnor?

FRANKU

Spettingu, cili tjetër? Fshihi shpejt se kam turp! (*Jaku e Karlli dalin*)

SQENA 2
FRANKU, SPETTINGU

SPETTING

(*Tuke hyrë*)

Këtu qënke, o ylli im? Po të kërkonja, s'lashë vënt! Ah, ti je për mua hylli i mëngjesit, drita e Djellit, Hëna e... natës. (*Me vehte*) ç't'i them tjetër, që s' kam haber nga poezia? (*Fillon ta zerë për qafe, por Franku shmanget me marifet*).

FRANKU

Aman, aman, ruaju mos na shëkojnë, se kam shumë turp!

SPETTING

Pse trembesh, kur se do jesh imja?

FRANKU

Kam frikë se mos thonë, se qënkam tërbuar për burrë!

SPETTING

(*Qesh*)

Nuk i le të thonë ç'të duan? Ç'të ze qederi?

FRANKU

Nuk dua të më pëlcasë cipa që tani, A! A! Spettingu im, duhet të ruhemi nga gjuhët e këqija!

SPETTING

(*Me vehte*)

Sa modeste që është! Oh, sa më enthusiasin fjalët e saj, e si do mos kur më quan "Spettingun e saj"! (*Frankut*) Folë, folë, o e dashur!

FRANKU

Ç'të them? (*Me vehte*) Tu thaftë koka veç.... ty gërmuq, që u prishe mëntsh krejt! (*Spettingu i turret prapë, po Franku e ndalon*). A! A!... zure prapë? S'të le të më zesh për qafe!... Dua më parë të më japësh fjalën se do t'i japësh lejën Zojushes Anna të martohet me nipin t'em Karllin, mbasi duhen kaqe fort, ç' thua?

SPETTING

Për hatrin tënt po ja jap lejën Annës.

FRANKU

Po zojushes tjetër, Kettyt, a ja jep lejën të martohet me Jakun?

SPETTING

Pse interesohesh kaqe fort?

FRANKU

Interesohem, se është miku i ngushtë i nipit t'em e s'bën të mbetet edhe ky i pa martuar. Mejto sa mirë do të shkojnë çupat, po të jenë të dyja bashkë!

SPETTING

Po ti a ma jep fjalën se do jesh krejt imja?

FRANKU

Me mish e me shpirt!

SPETTING

Ahere po u jap lejën që të dyjave.

FRANKU

Me shkrim?

SPETTING

Qysh me shkrim?

FRANKU

Me nënëshkrimin t'ënt dua të them, se ndryshe fjalët i merr era.

SPETTING

Ç'ka edhe ajo bëhet. Ahere pra, më lejo të të shtërngonj një herë në krahrorin t'im, se plasa! (*Fillon ta përqafojë, por Franku prapë e ndalon*)

FRANKU

Aman, aman, mos që tani, se kemi kohë për këto... Tani ma fal se kam për të bërë ca vizita e po shkonj shpejt (Largohet*, tuke i dërguar Spettingut* të *puthura me dorë*) Adio! (*Del jashtë*).

SPETTING

Ah, ç'ma punoj shenjtanja! (*Del edhe ky*)

SQENA 3

JAKU e KARLLI, pastaj KETTY e ANNA

JAKU

More, i mallkuari sa mirë që ja shkëputi fjalën Spettingut për të dy zojushet!

KARLLI

Është dreqi vetë, të kam thënë!

JAKU

A e pe si i rëshqiste si ngjalë?

KARLLI

Po, po, është kopil-kopili Franku për kësij punësh!

KETTY e ANNA

(*Tyke hyrë brenda*).

Këtu qënki?

JAKU

Zojusha, mbesonj se do na mbarohen qëllimet tona, kini shpresë.

KARLLI

Tetua ime e bindi Spettingun t' ju japë lejën që të dyjave!

ANNA

Vërtet?

KETTY

E bindi Spettingun që të na lejojë të martohemi?

JAKU

Fjalën ja dha një herë.

KARLLI

Do t' ja japë edhe me nënëshkrimin e tij.

ANNA

Jini të sigurt?

KARLLI

E dëgjuam me këto veshët t'ona!

KETTY

Oh, sa gëzohemi!

JAKU

Është punë e mbaruar këjo, përgëzimet t'ona (*I ze përdore të dyja*)

ANNA

Unë s'jam e qetë, gjer sa të shoh nënëshkrimin e tij!

KARLLI

Kini pak durim, se do ta shihni.

KETTY

Po Dona Luçija a ka ndo një kundërshtim të martohet me Spettingun?

KARLLI

Ajo është pun' e tyre, ju mos u bëni merak!

ANNA

Po tetua jote, Karll, a na pëlqeu ne që të martohemi me ju?

KARLLI

Fjal' i thon' asaj? Nuk e patë si ju puth e ju shtërngon?

ANNA

Mirë thua. Është shum' e dashur tetua jote!

JAKU

(*Me vehte*)

Do ish më mirë si kur mos t'i puthte, po s'kemi ç'bëjmë!

ANNA

Sa na gëzuar zembrat! A dalim tani jashtë?

KARLLI

Vemi ku të dëshëroni (*Zijen krah për krahu dhe dalin*).

SQENA 4

LUÇIJA, EMMA, pastaj FRANKU

LUÇIJA

(*Emmës*)

A munde të marrësh vesh këtë lodër që po xhvillohet mbi kurrizin t'em me atë Dona Luçija të gënjeshtërtë, që po bën rrollin t'em? Unë s'kam kuptuar gjë akoma!

EMMA

Kini kap durim, se do ta merrni vesh edhe ju ....

LUÇIJA

Pse, e ditke ti e s'ma thua akoma? Atëhere qënke e keqe për mua!

EMMA

(*Qesh*)

S' kini të drejtë, tetua ime, të ankoheni kundra meje, se kur ta merrni vesh do më jepni të drejtë të plotë.... Nuk më thoni, ku e kini shallën e madhe? Mos e harruat në kopsht?

LUÇIJA

Mirë thua, atje do t'a kem harruar. Të lutem shko ma merr e ma sill (*Emma del me një herë, ndërsa hyn Franku).*

FRANKU

(*Tuke hyrë edhe pa parë Luçinë*)

Uf!... plasa!... S'i duronj më këto thasë! Çudi si bëjnë grat' e mjera!... Më plasi shpirtin ky Spettingu... M'u ngjit si rodhja pas këpuce!.... (*Tuke parë Luçinë)*. Ah, ma fal, zonja Thompson, këtu qënki? Nuk ju vura re! Ma falni, se po ju le prapë të qetë ....

LUÇIJA

(*E ndalon të shkojë*)

Prisni pak, mos u ngutni, zonja Allvadorès, kam një fjalë me zotrinë t' uaj.

FRANKU

(*Me vehte*)

Medet më preu! .... Kush e di se ç'do më thotë prapë!

LUÇIJA

Nuk më thoni, zonjë, i ndyeri burri juaj Don Pietrua ....

FRANKU

(*Me vehte*)

Prapë Don Pietrua në mes! .... Akoma s'ka mbaruar kjo histori? Oh, taksirat që më gjeti!

LUÇIJA

(*Pason*)

Ju kishte bërë ndo një herë fjalë për mua?

FRANKU

Si quhi zotrija juaj?

LUÇIJA

Qysh nuk më njihni? Ju duhet të më njihni mirë, mbassi unë jam si e shtëpisë s'uaj.

FRANKU

Çudi do t' ju kem harruar! .... Pas gjëmës, që më gjeti ....

LUÇIJA

Ç'farë gjëmet?

FRANKU

Si, ç'farë gjëmet? E pakët është këjo që humba burrin e dashur?

LUÇIJA

(*Me vehte*)

Sa kornaze është (*Frankut*) Pun' e vjetër ajo, ajy ka tash 15 vjet që ka vdekur ...

FRANKU

Ç’ thua shkuan 15 vjet qysh ahere? E mua më duket si kur vdiq dje! Sa jam i .... pardon ... e habitur!

LUÇIJA

(*Me vehte*)

Sa dinake që është! Po ku do më vejë? Tani do ta ze në preshtë! (*Frankut*). Mbani mënt sa herë vamë bashkë në Buenos Aires? Në Montevideo? Në ....

FRANKU

Po, po, kini të drejtë, tashmë bije ndër mënt ... në Video ....

LUÇIJA

Montevideo ....

FRANKU

Po, po ... në Montevidello ....

LUÇIJA

(*Çkulet së qeshuri*)

Duket se do mos .... e kini parë as ëndërr, apo jo? Me fjalë të tjera kuptova, zonjë, se nuk jini ju Dona Luçija Allvadores!

FRANKU

Qysh? .... Nuk jam unë? .... Po kush ësht’ ahere?

LUÇIJA

Jam unë!

FRANKU

(*I habitur*)

Ju jini vërtet? Tetua e Karllit? Nga Brezili?

LUÇIJA

Unë, unë, mos dyshoni as pak!

FRANKU

Po un' ahere cila jam?.... Ha!.... pardon.... më falni.... diçka kam harruar në atë dhomën tjetër e po shkonj ta marr....(*Fillon të dalë jashtë i turpëruar, po të dera takohet me Emmën, e cila e ndalon)*.

EMMA

He, he, ku po shkon, Frank?

FRANKU

(*Nga dale Emmës*)

Lermë, aman të ikinj, në daç lakrat, se u turpërova krejt! Na dolli kallaji në mejdan!

EMMA

(*Nga dale Frankut*)

S'ka gjë, rri rehat, se atë punë e ndreq unë.

FRANKU

E ndreq ti? Po këtyre fustaneve ç't'u bënj?

EMMA

(*E ze përdore dhe e tërheq pranë Luçisë*)

Tetua ime e dashur, kam nderin t'ju presentonj të dashurin t'em, z. Frank Baverley, për të cilin ju kam bërë fjalë kaqe herë! Ky ësht' i tëri e rastisa këtu!

LUÇIJA

Qysh? Zotrija juaj qënki z. Baverley? Oh, sa gëzohem! (*E përshëndosh*). Sa mirë që të gjetmë këtu? Pse s' ma theshe kaqe orë, po më shkonje si Dona Luçija Allvadorès?

FRANKU

Ma fal, zonjë, se s'është faji im, po i atij lanetit nipit t' ënt! Ajy më bindi e u mvesha kështu, si po më shihni, sa të mbaronjë qëllimet e tija, ajy dhe ajy kopili tjetër, shoku i tij, Jaku!

LUÇIJA

(*Qesh me zemër*)

Ç'ka. Po nuk më thoni, ç'qëllime ka pasur Karlli si dhe z. Jak?

FRANKU

Karlli e Jaku, zonjë, dashurojnë të dy mbesat e z. Spetting, prandaj, mbassi ju prisnin ju, që me shkak t'i ftonin edhe çupat, ju nuk arthtë e u shtërngova unë të los rrollin t'uaj, që të gënjejmë z. Spetting, i cili edhe u gënjye, tuke kujtuar se jam unë milionarja Dona Luçija Allvadortès! Këjo është tërë komedija!

LUÇIJA

Tani po i mar vesh të gjitha.

FRANKU

Po, tani gjeta belanë, zonjë ....

LUÇIJA

Me cilin gjete belanë?

FRANKU

Me Sir Spettingun, se ky, tuke kujtuar se jam milionarja Dona Luçija Allvadorès, m'u hoth për sipër me gjithë kuptimin e fjalës e nuk di si të bënj.

LUÇIJA

Pse? ç'kërkon?

FRANKU

Kërkon të më marrë grua pa një pa dy!

LUÇIJA

(*Shkulet së qeshuri*)

E tani?

FRANKU

Tani, mbassi u gjent Dona Luçija e vërtetë, do t'ju le t'i zgjithni hesapet bashkë!

LUÇIJA

(*Qesh me zemër*)

E ju ç' do bëni ahere?

FRANKU

Do shkoj të çvishem, se mjaft i mbajta këto roba! Do shkonj të rimarr edhe një herë titullin e burrit!

LUÇIJA

Tani po ju pyes z. Baverley, a e doni dhe ju me të vërtetë Emmën?

FRANKU

Unë s'e dua Emmën? Më pyesni akoma? E kërkonja në Qiell dhe e gjeta mbi Dhè! Në mos më zijni besë, ju jap prova të kjarta.

(*Sulet e e përfshin Emmën për qafe dhe e puth).*

LUÇIJA

He, he, përpara meje kështu?

FRANKU

Ishte nevoja t'jua shprovonj, mbassi nuk besonit! Bëra gabim?

LUÇIJA

Ah, sa shejtan që je; me të vërtet meriton ti për Emmën t'ime.

EMMA

Është kaqe i mirë Franku, tetua ime, sa ....

LUÇIJA

Mjaft, mjaft, e mora vesh.... Tani pra, po ja jap lejën nga ana ime (*tuke i bashkuar)* dhe u trashëgofshi!

EMMA, FRANKU

Ju falemi nderit fort.

LUÇIJA

Ne me Emmën do shkojmë pak në hotel të mvishemi më mirë, pastaj do piqemi prapë.

FRANKU

Edhe unë atë punë do të bënj, se plasa kështu si jam! Uf, do shpëtonj më së fundi!

EMMA

Ti duhet të rrish akoma këtu, Frank, gjer sa t'i japësh funt çështjes së Karllit e Jakut me zojushat. Ku do që është z. Spetting do të vijë dhe si të mbarohesh me atë ahere ke fjalë me mua.

FRANKU

Mirë fort, u bëftë ashtu si thua. E shoh se ty ta pret më mirë se mua. Ahere shkoni ju, se unë po qëndronj këtu.

LUÇIJA

Lamtumirë z. Frank i dashur ....

EMMA

Adio, Frank, mos u mërzit gjer sa të kthehemi.

FRANKU

Goodbye, po mos vonohi .... (*Luçija dhe Emma dalin*)

SQENA 5

FRANKU vetëm, pastaj BRASSET

FRANKU

Më së fundi mundimet nuk më shkuan kot! Vërtet u bëra qesharak me këto roba, po këjo më dolli për mirë. E pandehnja kurrë edhe si do mos në këtë kohë kritike, që s' kam të holla as për duhan, të më dalë Emma përpara, ky ëngjëll shpëtimi? Vaj halli ç' do bëhet që këtej e tutje kur të futim hundët në milionat e s'ime vjehre, tetos së Karllit, ahere do jetë ç'do jetë! Ah, sa i lumtur që jam!.... Po tani duhet të mbarojmë edhe me Spettingun, se s'bën vetëm ne të jemi të lumtur dhe ata të na bëjnë sehir për së largu!.... I shkreti Spetting s'më ndahet! Ju mbush mëndja të më marrë grua! Kur mejtonj se ç'do të bënjë, kur të shohë se u gabua!....I mjeri është për t'u mëshiruar! Do t'i frynjë e do mos ftohet! (*Hyn Brasseti)*.

BRASSET

Zotni, zotni Frank! ....

FRANKU

Bretku, i marrë, sa më trembe! Pse nuk troket kur hyn brenda? Si do mos kur e di se është një zonjë brenda?

BRASSET

Ma fal, Dona Luçija

FRANKU

Ç'ma solle kokën?

BRASSET

Më kishit porositur t' ju sjell robat t' uaja ....

FRANKU

He, i solle, pra?

BRASSET

I solla, i kam në odën tjetër. Po të doni urdhroni të çvishi.

FRANKU

Futi në gardarobën, se kam akoma punë me këto fustanët.

BRASSET

Ç'ka, kur të dëshëroni më thoni (*del jashtë*)

FRANKU

S'më durohet gjer sa t'i marr Spettingut pohimin me nënëshkrimin e tij. Po pastaj si do t'i dal përpara! .... Medet!

SQENA 6

FRANKU, KETTY, ANNA,
pastaj SPETTINGU.

KETTY dhe **ANNA**
(*Tyke hyrë*)

Ho, e dashura Dona Luçija! (*E rrokin për qafe*). Këtu je akoma?

FRANKU
(*Me vehte*)

Kam pastaj faj unë pse më zenë këto për qafe? (*Ketty e Anna i rrijnë Frankut më gjunjët, njëra andej e tjetra këtej).*

KETTY

He, a ja muart lejën kujdestarit t' onë?

FRANKU

Po e pres të ma bjerë këtu. (*Kettyt*) Nuk më thua, zojushe, a e do ti shumë Jakun?

KETTY

Unë? Munt t'ju them se vdes për atë!

FRANKU

Bravo! (*Annës*) Po ti, mos sylarushkë, a e do Karllin t'em?

ANNA

Aqe e dua sa s'tregohet!

FRANKU

Bukur!

SPETTING

(*Tuke hyrë*)

Bre, bre, bre, ç'po më shohin sytë! Mbesat e mija mbi gjunjët e së dashurës s'ime!

FRANKU

Urdhro, urdhro, i dashuri im.Po çmallemi këtu me shoqja shoqen, si gra që jemi. Ah, t'a dinje sa shumë që i dua që të dyja!

SPETTING

Ashtu dëshëroj edhe unë, të duhi në mes t'uaj, mbassi do t'ju bëjnë teton e tyre!

FRANKU

(*Me vehte*)

Në atë krah të flesh! (Spettingut). Po, po. A ma solle atë që të thashë?

SPETTING

Këtu ta kam (*Nxjerr nga portofoli një shkresë e ja dorëzon Frankut*). Urdhro, merre.

FRANKU

Falemi nderit shumë.

ANNA e KETTY

(*Mundohen t' ja marrin Frankut shkresën nga dora)*

Ç'është këjo shkresë?

SPETTING

Është leja ime, që po ju jap të dyjave të martohi, njëra me z. Jakun dhe tjetra me z. Karllo, nipin e kësaj zonje.

KETTY e ANNA

(*I hidhen për qafe Spettingut*).

Oh, sa ju falenderojmë!

SPETTING

Të falenderoni më fort këtë zonjën fisnike, për hatër të së cilës po ju lejonj!

ANNA e KETTY

(*E zenë për qafe Frankun*)

Na rrofsh sa malet!

SPETTING

Tani, zojusha, më lejoni edhe mua ta përfshinj një herë për qafe të dashurën t'ime! (*Fillon t'a zerë, po Franku i rrëshqet prapë*). Qysh? As tani nuk më lejoni? (*Anna e Ketty unjin sytë*).

FRANKU

A, A, jo këtu, të lutem, edhe si do mos përpara zojushavet! Ç'na mbetet ahere? Këjo më poshtëron dinjitetin t' im, si Dona Allvadorès! Tani të lutem, largohu pak, se kemi kohë kur të flasim. Kam akoma pak punë me zojushet, mbesat e mija.

SPETTING

More, sa turp që ka, me gjith që është e vehë! Ja kështu më pëlqen. (*U sillet zojushave dhe Frankut*). Ahere po ikinj, kur nuk më doni e kur ju ndalonj nga puna. Adio! (*Del jashtë*).

ANNA

More kuxim! Nuk e dinja kaqe kuximtar ungjin t' em!

KETTY

As unë dhe u çudita fort! .... (*Frankut*) Ku e kishim fjalën?

FRANKU

Në... të puthurat!... Puthmëni, sa të mundni, se pastaj nuk do t'ju lerë radhë z. Spetting! (*Anna e Ketty e përqafojnë prapë*)

ANNA

Tani e kemi lejën sigurisht?

FRANKU

Pa dyshim.

KETTY

Ma jepni pak ta këndonj?

FRANKU

Me gjith qejf! (*Ja dorëzon Kettyt shkresën*).

KETTY

(*Mbassi e këndon, gëzohet fort dhe e shtërngon edhe një herë Frankun*).

Bukur fort!

FRANKU

(*Annës*)

Po ti ç'rri si dru e nuk bën si këjo?

ANNA

Ah, pardon ... (*I hidhet Frankut në piqi e e shtërngon*).

SQENA 7

TË PARËT, KARLLI, JAKU

KARLLI e JAKU

(*Tuke hyrë brenda e tuke i parë në atë gjëndje*)

Breeeee!

KARLLI

(*Mundohet t'i tërheqë zojushat. Frankut nga dale*)

Si s'ke turp bre harbut!

FRANKU

(*Nga dale Karllit*)

Ja, këto janë që s'durohen! Qënkam edhe harbut, pa le! Nuk më lijni rehat, them unë? Ne gratë munt të bëjmë si të duam, s' vemë njeri qahaja[1]! (*Anna e Ketty zenë njëra Karllin e tjetra Jakun, tuke ju treguar shkresën e Spettingut, që përmban lejën e martesës së tyre*)

JAKU, KARLLI

Qysh? U mbarua puna?

ANNA e KETTY

Na e mbaroj e dashura teto!

KARLLI e JAKU

Vërtet? Bravo!.... (*E zenë Frankun për dore*). Të falenderojmë shumë! ...

[1] qehaja = Njeri i besimit që shërben pranë një patroni

FRANKU

Puthmëni dorën tani (*U a shtrin dorën, të cilën Karlli me Jakun ja puthin*). Kështu, po! Ejani, pra, t'ju japë uratën tetua... (*Të gjithë unjin gjunjët përpara Frankut, i cili, tuke u tallur i bashkon kokëmë kokë të gjithë e u jep uratën*). M'u trashë-gofshi e me një fat të sërmanjtë[1], si dëshëron tetua e Karllit.

TË GJITHË TË TJERËT

Amin.

FRANKU

Tani ja jepni edhe ju lejën tetos, se do vejë të çvishet. (*Jakut e Karllit nga dale*). Më munduat fort, turullakët e dreqit, po, dobarem[2] ju mbarova punë. Po edhe unë nuk dolla pa gjë, mos kini merak.

KARLLI e JAKU

(*Nga dale*)

Qysh? Pa na thuaj ....

FRANKU

(*Tuke u hequr veshët Karllit e Jakut*)

Kur të merrni vesh do mbeti me gojë hapur, sa edhe ju do habiti! Lamtumirë! (*Franku del*)

---

[1] sërmanjtë = prej sermi, prej argjendi.

[2] dobare = Të paktën, sidomos, paksëpaku

SQENA 8

TË PARËT, përveç FRANKUT

JAKU

(*Nga dale Karllit*)

Hallall i qofshin të gjitha ç'na bëri!

KARLLI

Tani që na mbaroj punë s' kemi ç't'i themi!

JAKU

Duhet të fillojmë të pregatitemi.

KARLLI

Ashtu kujtonj edhe unë ....

ANNA

A shkojmë të pijmë nga një birrë të ftohtë të freskohemi?

TË GJITHË

Vemi ... (*Dalin jashtë).*

SQENA 9

FRANCESKU, LUÇIJA

(*Tuke hyrë së bashku*)

FRANCESKU

Më duket se po shoh ëndër, e dashura Luçija, si kur flutu-ronj!

LUÇIJA

Edhe unë jam kaqe e lumur që të pashë edhe një herë!

FRANCESKU

S'duronj gjer sa të bashkohemi për jetë! Duhet t'ua njoftojmë edhe djemve t' onë këtë gëzim. Sa do gëzohen!

LUÇIJA

S'ka dyshim! Po duhet të presim pak, se paskan edhe ata një hall në mes tyre.

FRANCESKU

Ç'farë hallit?

LUÇIJA

Jaku yt dëshëron të martohet me Kettyn dhe Karlli im me Annën e z. Spetting dhe Frank Baverley, si e pe, lojti gjer tani rrollin e Donës Allvadorès si kur se të ish tetua e Karllit, që ta bindta z. Spetting, t'u jepte lejën zojushavet. Po për fat të keq të Frankut, Spettingu kërkon të martohet me atë, tuke kujtuar se është z. Allvadorès. Ky shejtan, bëri si bëri ja mori lejën Spettingut e kështu besonj se edhe ata të dy do martohen me të mbesat e atij.

FRANCESKU

Tani po e kuptonj mirë këtë komedi! Bre, bre, shejtanët se ç'i paskan punuar të shkretit Spetting.

LUÇIJA

Po të kallzonj edhe një tjetër, që ka marrëdhënje me këtë histori si edhe me historinë t'onë.

FRANCESKU

Urdhro, folë ....

LUÇIJA

Emma kish dashuruar dikur një student dhe këtë, lumërisht, e gjeti këtu. E kuptoni kush është?

FRANCESKU

Kush? Pa më thuaj, se jam shumë i kurreshtuar.

LUÇIJA

Ky është .... z. Frank Baverley!

FRANCESKU

Ç'po më thua? Ah, sa kombinezon i bukur ky! Shëko një herë se ç' do me thënë fat!

LUÇIJA

Edhe unë, si e pashë që dashuroheshin aqe shumë, ju dhashë lejën!

FRANCESKU

Shumë mirë bëre! E tani ku shkoi z. Baverley?

LUÇIJA

Shkoi të çvishet e të mveshë rrobat e tija, se e mbaroj punën.

FRANCESKU

Bravo! Qënka dreqi vetë edhe ky!

LUÇIJA

Është shum' i zgjuar e hymorist!

SQENA 10
TË PARËT, SPETTINGU

SPETTING
(*Tuke hyrë*)
Ma falni, këtu qënki?

FRANCESKU e **LUÇIJA**
Urdhro, z. Spetting

SPETTING
Z. Tsesney ju kërkoj edhe një herë pardon, në qoftë se pa dashur u ndodha rivali i juaj, se s'munt t'ju a fsheh tani, se Dona Luçija Allvadorès më ka hyrë shumë në sy, e, mbassi e pashë që më dashuron edhe ajo, vendosa të bashkonj fatin t' em me të sajin. Pra, si njeri i ndershim, ardha të shpjegohem edhe një herë me z. t' uaj, e po ju pyes seriozisht, a ësht' e mundur të hiqni dorë nga Dona Luçija?

FRANCESKU
(*Sheh Luçinë në sy edhe qesh*)
Z. Spetting, nga ana ime po deklaronj edhe përpara kësaj zonje, se ja u le sheshin të lirë.

SPETTING
Falemi nderit fort e fort! Me këtë bashkë kam nderin t' ju njoftonj se, tuke parë se djali i z. s'uaj z. Jak ka një karakter të lartë e fisnik, vendosa ta martonj me mbesën t'ime, zojushen Ketty, së cilës ja dhashë lejën.

FRANCESKU

Shumë mirë paski bërë, z. Spetting, ju falem nderit shumë.

SPETTING

Gjithashtu, për hatër të së dashurës s'ime Dona Luçija, i dhashë lejën edhe mbesës tjetër, zojushes Anna të martohet me të nipin e saj, z. Karlli.

LUÇIJA

Edhe unë, z. Spetting, ju falenderonj për së tepri.

SPETTING

(*Pak si i habitur*)

Zonja Thompson, kini ndo një marëdhënje dhe z. juaj me z. Karll Whitegham, që më falenderoni, si kur se t' ju interesonte këjo martesë?

LUÇIJA

E kam fis zotni Karllin, zotni, prandaj më ardhi mirë kur dëgjova nga ana e juaj se do ta martoni me zojushen Anna.

SPETTING

Ashtu? Ahere qënka mirë!

FRANCESKU

(*Nga dale Luçisë*)

I shkreti Spetting si do sillet, vallë, kur të marrë vesh se ç' farë komedi u lojt mbi kurrizin e tij!

LUÇIJA

(*Nga dale Franceskut*)

Është për të mëshiruar derëziu!

SQENA 11

TË PARËT, JAKU, KARLLI, ANNA,
KETTY pastaj BRASSET

JAKU

(*Tuke hyrë me të tjerët Spettingut*)

Ju falemi nderit tepër, z. Spetting për mirësinë t'uaj, që lejuat zojushen Ketty të martohet me mua.

KARLLI

(*Gjithashtu Spettingut*)

Edhe unë, z. Spetting, ju falenderonj nga zembra për mirësinë që pattë, të më jepni dorën e zojushes Anna që e kam dashuruar kaqe shumë.

JAKU

(*I rekomandon t' et të vluarën e tij)*

Baba, u presentonj të vluarën t'ime, zojushen Ketty Spetting. (*Francesku e zè për qafe Kettyn).*

FRANCESKU

U trashëgofshi e me fat të mirë.

KETTY

Falemi nderit shumë.

KARLLI

(*Luçisë nga dale*)

Pastaj do t'ju paraqis edhe unë të vluarën t'ime, teto e dashur, mbassi të marrë funt komedija që po lot Franku.

LUÇIJA

(*Nga dale Karllit e tuke qeshur*)

I mora vesh të gjitha.

SPETTING

(*Karllit*)

Tani më përgëzo edhe mua, z. Karll, që do bëhem i shoqi i s'at' emte, Donës Luçija Allvadorès, që edhe ti do bëhesh nipi im me gjithë që do më kesh edhe vjehr. (*Qeshin të gjithë, tuke sjellë ndër mënt dushin që do pësonjë për pak Spettingu)*.

FRANCESKU

Edhe unë, zojusha e zotërinj, ju lutem të merrni pjesë në gëzimin t'onë me këtë zonjë (*tregon Luçinë*), se pse dhamë zembrat shoqi-shoqit që të bashkohemi për jetë.Ju paraqit DONËN LUÇIJA ALLVADORES

SPETTING

(*Krejt i habitur*)

Ç'dëgjova? Dona Luçija Allvadorès?

LUÇIJA

(*Spettingut*)

Po, z. Spetting, e vërteta Dona Luçija Allvadorès jam unë, tetua e z. Karrl, e jo ajo zonjë që kini njohur gjer tani për z. Luçi Allvadorès!

SPETTING

(*Gati i marrë mëntsh*)

Qysh, qysh? Gjithë kjo komedi, pra, u lojt mbi kurrizin t' em? (*Çohet më këmbë si i prishur mëntsh)*. Ah, ku do më vejë ajo grua e keqe, që u tall me mua kaqe paturpësisht!

SQENA 12

TË PARËT, FRANKU me EMMËN, pastaj BRASSET

(*Franku me Emmën zënë krah për krahe*
mveshur bukur hyjnë në sqenë)

FRANKU

(*Spettingut*)

Ma fal, sir Spetting se zonja që kishit njohur gjer tani, si Dona Luçija Allvadorès, s'ishte grua, po... burrë! Isha unë dhe tash po ju rekomandohem, jam z. Frank Baverley, lordi i Portlandit.

SPETTING

(*I lëshohet Frankut, si i marrë*)

Ti je? Ti e imitove kaqe bukur Donën Allvadorès, ti i paturpshëm? Ti më rrejte mua kaqe poshtërsisht? Jazëk të qoftë! Më shkëpute përdhunisht edhe të dy mbesat e mija, maskarâ, arrakat, i pabukshëm.... (*Sulet ta godasë, por e ndalojnë të tjerët)*

TË GJITHË

Ha, ha, haaaaa! .....

SPETTING

(*Frankut*)

Do ma paguash shtrenjt këtë përdhuní!

BRASSET

(*Tuke hyrë brenda me një dhisk me plot gota me lemonada të ftohta, i afrohet Spettingut*)

Urdhro, zotní Spetting, është një lemonadhë e ftohtë dhe do t'ju bënjë mirë, se kini nevojë këtë çast! ....

SPETTING

(*E shtyn*)

Këput qafën, i dobët, se ti m'i shkaktove të gjitha!

FRANKU

Zonja e zotërinj, kam nderin t'ju paraqit të vluarën t'ime, zojushen Emma Brown, vajzën e adoptuar të tetos së Karllit....

TË GJITHË

(*Frankut e Emmës*)

U trashëgofshi! ....

SPETTING

(*Merr kokën në të dy duart*)

Ah! .... Vetëm unë e pësova!!!

Bije napa

FUNDI I AKTIT III
dhe i gjithë komedisë.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Brandon, Thomas
Tetua e Karllit: komedi në 3 akte / Thomas Brandon;
përkth. shqip nga inglishtja Kristo Floqi;
transkriptoi e pregat. për bot. Henrik Kaçulini
Bot. i 2-të. - Durrës: Jozef, 2026.
138 f. ; 14.5 x 20.5 cm
ISBN 9789928941862
1.Letërsia angleze 2.Komedia
821.111 -22